

LIBRI I ABSTRAKTEVE BOOK OF ABSTRACTS

**Nga konferenca shkencore ndërkombëtare
20 shtator 2024**

Vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare në arsimin parauniversitar në
Kosovë: përvojat dhe perspektiva për të ardhmen

**International Scientific Conference
September 20th, 2024**

National and international evaluations in pre-university education in
Kosovo: experiences and future perspectives



**Prishtinë, shtator 2024
Prishtina, September 2024**

LIBRI I ABSTRAKTEVE BOOK OF ABSTRACTS

**Nga konferenca shkencore ndërkombëtare
20 shtator 2024**

Vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare në arsimin parauniversitar në
Kosovë: përvojat dhe perspektiva për të ardhmen

**International Scientific Conference
September 20th, 2024**

National and international evaluations in pre-university education in
Kosovo: experiences and future perspectives

**Prishtinë, shtator 2024
Prishtina, September 2024**

Botues/Publisher:

Instituti Pedagogjik i Kosovës
Kosovo Pedagogical Institute

Për botuesin/On behalf of the publisher:

Ismet Potera, zëvendësues i drejtorit/Acting director

Korrektues gjuhësor/Language editor:

Bekim Morina

ISSN: 3006-9572 (Print)

ISSN: 3006-9580 (Online)

Përgatiti për botim/Prepared for publication:

Skender Mekolli

Shtypi/print

Shtypshkronja "Blendi", Prishtinë

Printing Haus "Blendi", Prishtina

Koordinatorë të Konferencës/Conference Coordinators:

Dr. Osman Buleshkaj
Agim Bujari, PhD.C

Këshilli Shkencor i Konferencës/Conference Scientific Committee:

1. Dr. Ismet Potera, IPK
2. Dr. Safete Shala, IPK
3. Dr. Murteza Osdautaj, IPK
4. Dr. Tringa Dedi
5. Dr. Majlinda Gjellaj, FE/UP
6. Dr. Iliriana Tahiraj, FE/UP
7. Dr. Majlinda Keta, U. Tiranë
8. Dr. Gerda Sula, U. Tiranë
9. Dr. Demush Bajrami, UEJL
10. Dr. Arafat Shabani, UEJL

Këshilli Organizativ i Konferencës/Conference Organizing Committee:

1. Dr. Osman Buleshkaj
2. Agim Bujari, PhDc
3. Luljeta Shala, PhDc
4. Bekim Morina, PhDc
5. Mevlude Aliu-Gashi, PhDc
6. Selim Mehmeti
7. Arbnesha Mexhuani
8. Skender Mekolli
9. Fitore Maliqi
10. Valon Gajraku
11. Granit Duli

Përmbajtja/Contents

Parathënie/Preface	Error! Bookmark not defined.
Folësit kryesorë/Keynote speakers	11
Bardhyl Musai Qasjet dhe strategjitë e përdorimit efektiv të rezultateve të vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare Approaches and Strategies for the Effective Use of National and International Assessment Outcomes.....	12
Ismet Potera Përvojat e vendeve pas vlerësimit PISA dhe Kosova Countries' Experiences after the PISA Assessment and Kosovo	15
Dukagjin Pupovci Kosova në pasqyrën e PISA 2022 Kosovo in the Overview of PISA 2022	17
Nikoleta Mita Krahasimi i vlerësimeve kombëtare me përvoja nga vendet e tjera Comparison of National Assessments with the Experiences of other Countries	19
Blerim Saqipi Politikat dhe praktikat e zhvillimit të mësimdhënësve në Kosovë: dilema mes përcjelljes së trendeve dhe adresimit të kontekstit lokal Teacher Development Policies and Practices in Kosovo: The Dilemma between Following Trends and Considering the Local Context.....	22
Murteza Osdautaj Rezultatet e testeve PISA dhe PIRLS dhe rezultatet e studimeve të kryera në terren The results of the PISA and PIRLS tests compared to results from field studies	24
Avni Rexha & Fatmir Elezi Sistemi aktual i vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare The Current National Assessment System	27

Robert Blease

Si mund të ndikojnë gjetjet nga procesi i ngritjes së modelit të sigurimit të cilësisë i udhëhequr nga kolegët kosovarë në cilësinë e vlerësimit të nxënësve në Kosovë
 How findings from the Kosovan peer led quality assurance model building process can influence the quality of student assessment in Kosovo..... 29

Mihaela Singer, Armend Shabani, Dije Shatri, Fadil Latifi, Osman Buleshkaj

Vlerësimet në shkallë të gjerë karshi dilemave të mësimdhënësve për përmirësimin e praktikës së tyre në klasë
 Large-scale assessments versus teachers' dilemmas in improving their classroom practice 31

Sesionet paralele/Parallel Sessions 33**TEMA 1. SISTEMI AKTUAL I VLERËSIMEVE KOMBËTARE****TOPIC 1. CURRENT SYSTEM OF NATIONAL ASSESSMENTS 34****Fatmir Fejziu**

Vlerësimet kombëtare në arsimin parauniversitar në Kosovë dhe (mos) ballafaqimi me vlerësimet ndërkombëtare
 National Assessments in Pre-University Education in Kosovo and (Non)Confrontation with International Assessments..... 35

Xhavit Rexhaj

(Jo)Koherenca e Kurrikulës dhe vlerësimet në sistemin arsimor në Kosovë
 (In)Coherence of the Curriculum and Assessment in the Educational System in Kosovo..... 37

Lirije Vitija Reçica & Blerina Halilaj

Sfidat e vlerësimit kombëtar të nxënësve me nevoja të veçanta në arsimin parauniversitar
 Challenges of National Assessment of Students with Special Needs in Pre-University Education 39

Mimoza Hoti

Përdorimi i instrumenteve të duhura të vlerësimit të nxënësve drejt përmirësimit të të nxënësve dhe ngritjes së cilësisë në mësimdhënie
 Using the Appropriate Student Assessment Instruments to Improve Learning and Increase the Quality of Teaching 41

Selim Mehmeti

Përdorimi i rezultateve të vlerësimeve të nxënësve për përmirësimin e mësimdhënies dhe nxënies
Using Student Assessment Results to Improve Teaching and Learning 43

TEMA 2. KOSOVA NË VLERËSIMET NDËRKOMBËTAR

TOPIC 2. KOSOVO IN INTERNATIONAL ASSESSMENTS 45

Besart Hyseni

Hulumtimi i ndërthurjes së faktorëve ekonomikë, socialë, mjedisorë dhe politikë në
rezultatet e PISA-s

Examining the Intersection of Economic, Social, Environmental and Political Factors in
PISA Outcomes..... 46

Amantina Pervizaj Kelmendi

Integrimi i dimensioneve neurokognitive në vlerësimet arsimore: strategjitë për ngritjen
e cilësisë në vlerësimin kombëtar dhe ndërkombëtar në arsimin parauniversitar në Kosovë

Integrating Neurocognitive Dimensions in Educational Assessments: Strategies for Quality
Improvement in National and International Assessment in Pre-University Education in Kosov..... 48

Luella Liçi

Cilësia e përkthimit në gjuhën shqipe të instrumenteve të vlerësimit të PISA-s dhe TIMSS-it

The Quality of the Translation into Albanian of the PISA and TIMSS Assessment Instruments..... 50

Fadil Latifi

Ndikimi i faktorëve socio-ekonomik dhe edukimit të fëmijëve në fëmijërinë e hershme
në arritjet akademike të fëmijëve në TIMSS 2019

The impact of socioeconomic factors and early childhood education on children's academic
achievement in TIMSS 2019 52

Lekë Ukaj, Fatmir Mehmeti & Artan Reshani

Shqyrtimi i marrëdhënieve në mes të angazhimit të brendshëm akademik, kuriozitetit,
ankthit ndaj matematikës dhe suksesit në testin PISA

Exploring the relationships between internal academic engagement, curiosity, math
anxiety, and success in the PISA test 54

TEMA 3. KRAHASIMI I VLERËSIMEVE KOMBËTARE ME PËRVOJA NGA VENDET E TJERA	
TOPIC 3. COMPARING NATIONAL ASSESSMENTS AND EXPERIENCES FROM DIFFERENT COUNTRIES	56
Bardha Gashi	
Roli i vlerësimit formativ në përmirësimin e rezultateve të vlerësimit kombëtar dhe ndërkombëtar	
The Role of Formative Assessment in the Improvement of National and International Assessment Results.....	57
Belgizare Kryeziu & Ismet Potera	
Ndikimi i kurrikulës në arritjet e nxënësve në testimet kombëtare dhe ndërkombëtare	
The Impact of the Curriculum on Students’ Achievement in National and International Tests	59
Kujtime Kryeziu	
Roli i arsimit parashkollor në performancën e nxënësve në Kosovë në testin PISA: Një analizë krahasuese me vendet e rajonit	
The Role of Pre-School Education in Kosovo Students’ Performance in the PISA Test: A Comparative Analysis with Regional Countries	61
Sevdije Berisha Krasniqi	
Analizë krahasuese e testeve kombëtare dhe testit PISA në Kosovë	
A comparative analysis of national and PISA testing in Kosovo	63
Egzon Gashi	
Krahasimi i vlerësimeve kombëtare me përvoja nga vendet e tjera	
Comparison of National Assessments with the Experiences of Other Countries.....	65
TEMA 4. QASJET DHE STRATEGJITË E PËRDORIMIT EFEKTIV TË REZULTATEVE TË VLERËSIMEVE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE	
TOPIC 4. APPROACHES AND STRATEGIES FOR THE EFFECTIVE USE OF NATIONAL AND INTERNATIONAL ASSESSMENT RESULTS	67
Mihaela Singer, Armend Shabani, Dije Shatri, Fadil Latifi, Osman Buleshkaj	
Vlerësimi i nxënësve i reflektuar në librat shkollorë në Kosovë dhe efekti e tij në praktikën e mësimdhënies	
Student’s assessment reflected in the Kosovo textbooks and its interplay in the teaching practice.....	68

Bekim Morina, Zehrije Plakolli, Arbnesha Mexhuani & Agim Bujari	
Qasja metodike e mësimeve në zhvillimin e lexim-kuptimit të nxënësve	
Teachers' methodical approach to the development of students' reading comprehension	70
Gjylë Totaj, Fatmir Mehmeti & Artan Reshani	
Eksplorimi i marrëdhënieve në mes të angazhimit, kënaqësisë, kompetencës së perceptuar, vështirësisë së perceptuar në lexim dhe arritjeve në lexim	
Exploring the Relationships between Reading Engagement, Enjoyment, Perceived Competence, Perceived Difficulty, and Reading Achievement.....	72
Isak Kelmendi	
Bashkëpunimi i mësimeve lidhur me vlerësimin gjatë procesit mësimor	
Teacher Cooperation related to Assessment during the Learning Process.....	74
Lulzim Thaçi & Agim Bujari	
Kalimi nga vlerësimi tradicional "laps-letër" drejt vlerësimit elektronik të nxënësve në arsimin parauniversitar	
The Transition from the Traditional "Pen and Paper" Assessment to the Electronic Assessment of Students in Pre-University Education	76

Parathënie

Konferenca e Institutit Pedagogjik të Kosovës i kushtohet një prej temave më të ndjeshme vitet e fundit, siç është vlerësimi i nxënësve. Në këtë konferencë, vlerësimet kombëtare u referohen vlerësimeve të jashtme të standardizuara shtetërore, siç është Testi i Arritshmërisë (në fund të klasës IX) dhe Provimi i Maturës Shtetërore (në fund të klasës XII). Ndërsa vlerësimet ndërkombëtare u referohen testeve PISA, TIMSS dhe PIRLS, në të cilat aktualisht merr pjesë Kosova. Pas secilit vlerësim, kombëtar apo ndërkombëtar, rezultatet janë komentuar dhe debatuar më shumë në aspektin e gjetjes së faktorëve që ndikuan ato rezultate sesa në identifikimin e veprimeve që duhen ndërmarrë për përmirësimin e tyre.

Në abstraktet e dërguara nga autorë të ndryshëm: profesorë universitarë, studiues dhe mësimdhënës, shohim se sa kompleks është procesi i vlerësimit të nxënësve. Vlerësimet ndërkombëtare, si PISA, PIRLS dhe TIMS, nuk kanë për qëllim vetëm renditjen e vendeve në listën e rezultateve, por edhe promovimin e vlerave të përbashkëta arsimore. Për vendet pjesëmarrëse në këto vlerësime, rezultatet paraqesin një mekanizëm të mirë për të intervenuar në politikat e brendshme arsimore.

Në vendet me rezultate jo të mira në vlerësimet ndërkombëtare u zhvilluan debate dhe analiza nga ekspertë të fushës, vendimmarrës dhe mësimdhënës. Prandaj, edhe në këtë konferencë prezantohen krahasime të tilla në raport me zhvillimet në Kosovë. Këto analiza shihen në prizmin e kaheve të zhvillimit, qasjeve dhe mundësive për të bërë përmirësime në politika dhe në sistemin arsimor. Këto dhe aspekte të tjera të

Preface

The conference of the Kosovo Pedagogical Institute is dedicated to one of the most sensitive topics in recent years, i.e. student assessment. In this conference, national assessments refer to external standardized national assessments, such as the Achievement Test (at the end of the 9th grade) and the State Matriculation Examination (at the end of the 12th grade), while the international assessments refer to the PISA, TIMSS and PIRLS tests, in which Kosovo currently participates. After every national or international assessment, the results are commented and debated more in terms of finding the factors that influenced those results than in identifying the actions that should be taken to improve them

In the abstracts sent by different authors, including university professors, researchers and teachers, we see how complex the process of student assessment is. International assessments, such as PISA, PIRLS and TIMS, are not only aimed at ranking countries in the results list, but also at promoting shared educational values. For countries participating in these assessments, the results represent a good mechanism to intervene in domestic educational policies.

In countries with poor results in international assessments, debates and analyses were conducted by experts in the field, decision-makers and teachers. Therefore, this conference will also present such comparisons in relation to the developments in Kosovo. These analyses are seen from the perspective of development directions, approaches and opportunities to make improvements in education policies and the education system. These and other similar aspects

ngjashme janë pjesë e trajtimit nga studiues dhe zbatues të praktikave të vlerësimit në Kosovë.

Dilemat ndërmjet mësimeve dhe studiuesve arsimorë për pjesëmarrje në vlerësimet ndërkombëtare, përzgjedhja e mostrës së nxënësve, çështja e gjuhës së përkthimit të testeve, mbarëvajtja e procesit të vlerësimit dhe të monitorimit, si dhe përfshirja e nxënësve në nevojë në vlerësimet e jashtme, trajtohen nga prezantuesit në këtë konferencë. Disa autorë trajtojnë faktorët që ndikojnë në rezultatet e PISA-s dhe vlerësimet e tjera, si: faktorët socio-ekonomikë, angazhimi akademik, qasjet bashkëkohore, si dhe procedurat e format e vlerësimit.

IPK-ja mbetet e përkushtuar në trajtimin dhe kërkimin e zgjidhjeve për çështjet me rëndësi në sistemin e arsimit kosovar. Kjo konferencë është dëshmi e dhënies së kontributit të saj.

September 20, 2024
Dr Ismet Potera, KPI

are part of the treatment by researchers and implementers of assessment practices in Kosovo.

The dilemmas between teachers and educational researchers about participating in international assessments, the selection of the student sample, the issue of test translation, the smooth running of the assessment and monitoring process, as well as the inclusion of students in need in external assessments, are addressed by the presenters at the conference. Some authors deal with the factors affecting the results of PISA and other assessments, such as: socio-economic factors, academic engagement, contemporary approaches, as well as assessment procedures and forms.

The KPI remains committed to addressing and seeking solutions to important issues in the Kosovar education system. This conference is proof of its contribution.

September 20, 2024
Dr Ismet Potera, KPI

Folësit kryesorë/Keynote speakers

QASJET DHE STRATEGJITË E PËRDORIMIT EFEKTIV TË REZULTATEVE TË VLERËSIMEVE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

APPROACHES AND STRATEGIES FOR THE EFFECTIVE USE OF NATIONAL AND INTERNATIONAL ASSESSMENT OUTCOMES

Bardhyl Musai¹

Abstrakt

Rezultatet mjaft të ulëta të Kosovës në programet për vlerësimin e nxënësve kërkojnë domosdoshmërisht që sistemi arsimor të bëjë përmirësime të ndjeshme në përgatitjen e tyre dhe për këtë kërkohet bashkëpunim ndërmjet punonjësve të arsimit, politikëbërësve dhe prindërve, për të krijuar një mjedis mësimor mbështetës dhe të favorshëm. Kosova në këtë çerek shekulli ka njohur vazhdimisht nevojën në rritje për të integruar shprehitë e të menduarit të nivelit të lartë në kurrikulën shkollore. Këto përfshijnë reflektimin, arsyetimin, inovacionin, zgjidhjen e problemeve, krijimtarinë, kuriozitetin, pa lënë pas dore bashkëpunimin dhe komunikimin (shprehitë). Gjuha amtare, teknologjia, matematika dhe shkenca (përmbajtja) luajnë rol vendimtar në zhvillimin e shprehive për shekullin e 21-të. Angazhimi i nxënësve në këto disiplina inkurajon qasje inovative ndaj sfidave dhe rrit arsyetimin logjik – të gjitha këto aspekte themelore të shprehive njohëse të nivelit të lartë. Në këtë sipërmarrje arsimore, sfidat me të cilat përballen mësuesit ndikojnë drejtpërdrejt në aftësinë e tyre për të kultivuar këto shprehi te nxënësit. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional është thelbësor,

Abstract

Kosovo's rather low results in student assessment programmes necessarily require the education system to make significant improvements in their preparation, and for this to happen, cooperation between educators, policy makers and parents is required to create a supportive and favourable learning environment. Kosovo in this quarter of a century has continuously recognized the growing need to integrate high-level thinking habits in the school curriculum. These include reflection, reasoning, innovation, problem solving, creativity, curiosity, without neglecting cooperation and communication (habits). Native language, technology, mathematics and science (content) play a crucial role in developing habits for the 21st century. Engaging students in these disciplines encourages innovative approaches to challenges and enhances logical reasoning—all fundamental aspects of higher-order cognitive skills. In this educational enterprise, the challenges teachers face directly affect their ability to cultivate these habits in students. Continuous professional development is essential, yet many lack sufficient training and qualification in innovative teaching

¹ Prof. dr. Bardhyl Musai është profesor në Universitetin e Tiranës
Prof. dr. Bardhyl Musai is a professor at the University of Tirana

megjithatë shumë prej tyre nuk kanë trajnim dhe kualifikim të mjaftueshëm në metodologjitë novatore të mësimdhënies, që stimulojnë shprehitë e nivelit të lartë të të menduarit. Përmirësimi i rezultateve të testeve kombëtare e ndërkombëtare kërkon një qasje shumëplanëshe, që përfshin politikat qeveritare, strategjitë arsimore afatgjata e të qëndrueshme, dhe përfshirjen e komunitetit. Rekomandimet që sugjerojmë për të përmirësuar rezultatet e arritjeve të nxënësve përputhen me nxitjen e shprehive të shekullit të 21-të: të menduarit kritik, krijimtarinë, komunikimin, bashkëpunimin, kuriozitetin, të shkruarit dhe të lexuarit digjital dhe të nxënësve socio-emocional, thelbësore për suksesin në botën e sotme të ndërlidhur dhe që ndryshon me shpejtësi.



Biografia

Profesor dhe botues, i cili ia ka kushtuar karrierën e tij avancimit të arsimit në Shqipëri, në Kosovë e më gjerë, në rajon. Ekspertiza e tij mbulon një sërë temash arsimore, duke përfshirë zhvillimin e kurrikulës, politikat arsimore, dhe trajnimin e mësuesve, me fokus përmirësimin e cilësisë së arsimit. Ai ka bashkëpunuar me agjenci qeveritare, institucione arsimore dhe organizata

methodologies that stimulate higher order thinking skills. Improving national and international test scores requires a multifaceted approach that includes government policies, long-term and sustainable educational strategies, and community involvement. The recommendations we suggest to improve student achievement outcomes are consistent with fostering 21st century skills: critical thinking, creativity, communication, collaboration, curiosity, digital literacy and social-emotional learning, essential for success in today's interconnected and rapidly changing world.

Prof. dr. Bardhyl Musai

Biography

Professor and publisher, who has dedicated his career to the advancement of education in Albania, Kosovo and beyond in the region. His expertise covers a range of educational topics, including curriculum development, educational policy, and teacher training, with a focus on improving the quality of education. He has collaborated with government agencies,

ndërkombëtare për të zbatuar programe dhe strategji arsimore inovative. Puna e tij ka pasur ndikim të rëndësishëm në formësimin e peizazhit arsimor në Shqipëri dhe në Kosovë, duke kontribuar në zhvillimin profesional të mësuesve, profesorëve, dhe suksesin e nxënësve dhe studentëve. Si folës kryesor, Bardhyl Musai sjell në konferencë një pasuri dijesh, përvoja dhe ekspertize.

educational institutions and international organizations to implement innovative educational programs and strategies. His work has had a significant impact on the shaping of the educational landscape in Albania and Kosovo, contributing to the professional development of teachers and professors, and the success of pupils and students. As a main speaker, Bardhyl Musai brings a wealth of knowledge, experience and expertise to the conference.

PËRVOJAT E VENDEVE PAS VLERËSIMIT PISA DHE KOSOVA

COUNTRIES' EXPERIENCES AFTER THE PISA ASSESSMENT AND KOSOVO

Ismet Potera²

Abstrakt

Ky studim shqyrton përvojat e vendeve pas PISA-s, duke përfshirë aspektet kryesore të identifikimit të sfidave dhe mundësive në arsim, përmirësimin e politikave arsimore, si dhe ndikimin në praktikat mësimore dhe trajnimin e mësimeve. Studimet tregojnë se vendet si Gjermania, Norvegjia dhe Japonia i kanë përdorur rezultatet e PISA-s për të krijuar politika dhe strategji që adresojnë ndryshimet në performancën e studentëve, barazinë arsimore dhe efektivitetin e sistemeve të tyre arsimore. Studimet, gjithashtu, kanë identifikuar një varg faktorësh lidhur me "dështimet" e nxënësve në testin ndërkombëtar. Rezultatet dhe analizat e këtyre studimeve tregojnë disa nga mangësitë dhe zbrazësitë e sistemit arsimor të atyre vendeve. Reagimi i Gjermanisë pas testit PISA paraqet shembullin unik të se si një vend mund të përdorë rezultatet e një vlerësimi ndërkombëtar për të identifikuar dobësitë në sistemin e tij arsimor dhe për të ndërmarrë hapa konkretë për përmirësim. Qëllimi i këtij studimi meta-analize është të identifikojë gjetjet kryesore të studimeve të bëra për rezultatet pas PISA-s, në vende të ndryshme, rekomandimet dhe sugjerimet për sistemin, si dhe ndërlidhjen e mundshme me kontekstin kosovar. Disa nga gjetjet e studiuesve të ndryshëm mund të kenë ngjashmëri me faktorët e përgjithshëm që mund të

Abstract

This study examines countries' experiences after PISA, including key aspects of identifying challenges and opportunities in education, improving education policies, and impacting teaching practices and teacher training. Studies show that countries such as Germany, Norway and Japan have used PISA results to create policies and strategies that address changes in student performance, educational equity and the effectiveness of their education systems. Studies have also identified a number of factors related to students' "failures" in the international examination. The results and analyses of these studies show some of the shortcomings and gaps in the educational system of those countries. Germany's reaction to the PISA test provides a unique example of how a country can use the results of an international assessment to identify weaknesses in its education system and take concrete steps to improve it. The purpose of this meta-analysis study is to identify the main findings of the studies done on the results after PISA in different countries, the recommendations and suggestions for the system, as well as the potential relation with the Kosovar context. Some of the findings of different researchers may have similarities with the general factors that may have influenced the unsatisfactory PISA results of

² Dr. sci. Ismet Potera është hulumtues në IPK
Dr. Sci. Ismet Potera is a researcher at KPI

kenë ndikuar në rezultatet jo të kënaqshme në PISA të nxënësve kosovarë. Për këtë analizë, janë përzgjedhur disa studime, të botuara në revista të ndryshme shkencore. Nga ky studim meta-analitik do të përvijohen rekomandime specifike për institucionet arsimore relevante të vendit.

Fjalët kyçe: mangësitë e sistemit, meta-analizë, faktorë të suksesit, përmirësim i gjendjes, rezultatet e nxënësve.



Biografia

Zëvendësues i drejtorit të Institutit Pedagogjik. Hulumtues në fushën e zhvillimit profesional të mësimit dhe të nxënësve. Ekspertiza kryesore mësimit dhe të nxënësve, si dhe fusha të tjera arsimore si zhvillimi i politikave arsimore, zhvillimi i kurrikulës, hartimi i teksteve shkollë, vlerësimi i teksteve shkollë, trajnimi i mësimit dhe i drejtuesve të shkollës. Ai ka botuar një varg punimesh e monografi nga fusha e arsimit. Ka zhvilluar një varg vizitash studimore në rajon e më gjerë nga lëmi i arsimit dhe i edukimit mjedisor. Si folës në konferencë sjell një këndvështrim me interes për përvojat e vendeve të ndryshme lidhur me analizat pas vlerësimit ndërkombëtar PISA.

Kosovar students. For this analysis, several studies published in various scientific journals were selected. From this meta-analytical study, specific recommendations will be outlined for the relevant educational institutions of the country.

Keywords: shortcomings of the system, meta-analysis, success factors, improvement of the situation, student results.

Dr. sci. Ismet Potera

Biography

Acting Director of the Pedagogical Institute. Researcher in the area of professional development of teachers. Key expertise in teaching and learning, as well as other educational areas, such as educational policy development, curriculum development, textbook writing, textbook evaluation, teacher training and school management training. He published a series of works and monographs in the area of education. He has undertaken several study visits in the region and beyond in the area of education and environmental education. As a conference speaker, he is going to provide an interesting perspective on the experiences of various countries regarding post-analysis of the international PISA assessment.

Dukagjin Pupovci³**Abstrakt**

Ky fjalim hyrës është përmbledhje e një studimi të realizuar në vitin 2024, që ka pasur për qëllim të analizojë shkaqet pas rezultateve të dobëta të nxënësve kosovarë në tri ciklet e fundit të PISA-s dhe të propozojë masa konkrete për përmirësimin e performancës së tyre. Studimi është realizuar duke u bazuar në të dhënat e disponueshme publikisht nga OECD-ja. Krahasimet janë bërë me mesataren e OECD-së dhe vendet fqinje të Kosovës, për të vendosur performancën e Kosovës në një kontekst më të gjerë. Fokus kryesor i studimit është performanca në matematikë në PISA 2022 dhe faktorët që ndikojnë në të, si dhe aspektet e tjera të rëndësishme të arsimit, si barazia, klima shkollore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19. Rezultatet e nxënësve kosovarë në tri ciklet e fundit të testit PISA janë zhgënjyese, me rezultatet e PISA 2022, që janë më të dobëtat deri më tani. Kosova radhitet ndër të fundit në Lexim, në Matematikë dhe në Shkencë, pasi 83% të nxënësve në Lexim, 85% në Matematikë, dhe 79% në Shkencë nuk e përmbushin standardin minimal të arritjeve (niveli 2 i performancës). Nga ana tjetër, Kosova nuk ka nxënës me arritje të larta në asnjë disiplinë (nivelet 5 dhe 6 të performancës). Ndër faktorët që ndikojnë në performancën e nxënësve në matematikë janë ankthi nga matematika, mungesa e vetëbesimit për zgjidhjen e problemeve

Abstract

This abstract is a summary of a study carried out in 2024, which aimed to analyze the causes behind the poor results of Kosovar students in the last three cycles of PISA and to propose concrete measures to improve their performance. The study was conducted based on publicly available data from the OECD. Comparisons are made with the OECD average and Kosovo's neighboring countries, to place Kosovo's performance in a wider context. The main focus of the study is mathematics performance in PISA 2022 and the factors that influence it, as well as other important aspects of education, such as equity, school climate and the impact of the COVID-19 pandemic. The results of Kosovar students in the last three cycles of the PISA test are disappointing, with the PISA 2022 results being the weakest so far. Kosovo ranks last in Reading, Mathematics and Science, as 83% of students in Reading, 85% in Mathematics, and 79% in Science do not meet the minimum achievement standard (performance level 2). On the other hand, Kosovo does not have students with high achievements in any discipline (performance levels 5 and 6). Among the factors that affect the performance of students in mathematics are anxiety from mathematics, lack of confidence in solving mathematical problems and the occurrence of bullying in schools. Meanwhile, the socio-economic status, which includes the

³ Dr. Dukagjin Pupovci është profesor universitar dhe njohës i çështjeve arsimore
Dr. Dukagjin Pupovci is a university professor and an expert of educational issues

matematikore dhe dukuria e bullizmit në shkolla. Ndërkaq, statusi socio-ekonomik, ku përfshihet gjendja ekonomike e familjes dhe niveli arsimor i prindërve, ka ndikim të moderuar në rezultatin e nxënësve në matematikë. Studimi sjell rekomandime që ndahen në gjashtë kategori kyçe, të cilat synojnë përmirësimin e arsimit në Kosovë: 1) Kurrikulat dhe materialet mësimore; 2) Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë; 3) Furnizimi i shkollave me mjete dhe materiale mësimore; 4) Cilësia e mësimdhënies në shkolla; 5) Klima disiplinore në shkolla; 6) Rishikimi i sistemit të financimit në arsimin parauniversitar



Biografia

Ekspert i arsimit, ish-zëvendësministër i arsimit dhe ish-drejtor shumëvjeçar i Qendrës për Arsim të Kosovës, një ndër OJQ-të më të mëdha në Ballkan. Ka kontribuar në hartimin e studimeve të shumta për gjendjen e arsimit dhe kërkimit shkencor në Kosovë, si dhe të dokumenteve kryesore strategjike për zhvillimin e këtyre sektorëve. Profesor Pupovci mban gradën e doktorit të shkencave në fushën e matematikës së aplikuar. Për më shumë se 30 vjet ka qenë mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës, në të cilin ka mbajtur lëndë nga fusha e matematikës, shkencës kompjuterike dhe edukimit.

economic situation of the family and the educational level of the parents, has a moderate influence on the results of students in mathematics. The study brings recommendations that are divided into six key categories, which aim to improve education in Kosovo: 1) Curricula and teaching materials; 2) Internal and external quality assurance; 3) Supplying schools with teaching tools and materials; 4) Quality of teaching in schools; 5) Disciplinary climate in schools; 6) Review of the financing system in pre-university education.

Prof. dr. Dukagjin Pupovci

Biography

Education expert, former deputy minister of education and long-time former director of the Kosovo Education Center, one of the largest NGOs in the Balkans. He has contributed to the drafting of numerous studies on the state of education and scientific research in Kosovo, as well as the main strategic documents for the development of these sectors. Professor Pupovci holds the degree of Doctor of Sciences in the field of applied mathematics. For more than 30 years, he has been a teacher at the University of Prishtina, teaching courses in the field of mathematics, computer science and education.

KRAHASIMI I VLERËSIMEVE KOMBËTARE ME PËRVOJA NGA VENDET E TJERA

COMPARISON OF NATIONAL ASSESSMENTS WITH THE EXPERIENCES OF OTHER COUNTRIES

Nikoleta Mita⁴

Abstrakt

Ky referim paraqet çështje themelore të vlerësimit kombëtar në arsimin parauniversitar, si pjesë e sistemit të sigurimit të cilësisë, në një këndvështrim krahasimor të përvojës së Kosovës me përvojat e rreth 20 vendeve të botës. Përvojat janë krahasuar përkundrejt modelit të vlerësimit arsimor kombëtar, politikës arsimore kombëtare për vlerësimin, bazës ligjore dhe rregullatore që mbështet vlerësimin arsimor kombëtar, qëllimeve të vlerësimit arsimor kombëtar, institucioneve përgjegjëse për vlerësimin arsimor kombëtar, përdorimit të të dhënave të vlerësimeve kombëtare, sfidave dhe zhvillimeve të së ardhmes dhe lidhjes së vlerësimit kombëtar në arsim me vlerësimet ndërkombëtare ku vendet kanë qenë pjesëmarrëse. Referimi është përgatitur mbi bazën e të dhënave dytësore të organizmave ndërkombëtarë për arsimin dhe të rreth 20 vendeve. Janë studiuar dhe përdorur dokumente ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsim, strategji ndërkombëtare për arsimin, rezoluta të institucioneve përgjegjëse për politikën arsimore; dokumente vendore, si: dokumente të politikave arsimore, dokumentacioni ligjor dhe rregullator, manuale për vlerësim, raporte të vlerësimeve kombëtare, kërkime shkencore për vlerësimet

Abstract

This reference presents fundamental issues of national assessment in pre-university education, as part of the quality assurance system, in a comparative perspective of Kosovo's experience with the experiences of about 20 countries around the world. Experiences are compared against the national educational assessment model, the national educational policy for assessment, the legal and regulatory framework supporting national educational assessment, the goals of national educational assessment, the institutions responsible for national educational assessment, the use of national assessment data, future challenges and developments and the connection of the national educational assessment with the international assessment where countries have participated. The reference was prepared on the basis of secondary data of international organizations for education and of about 20 countries. International documents for quality assurance in education, international strategies for education, resolutions of institutions responsible for educational policies have been studied and used; local documents, such as educational policy documents, legal and regulatory documentation, assessment manuals, national assessment reports, scientific research on national

⁴ Prof. dr. Nikoleta Mita është profesoreshë në Universitetin e Tiranës
Prof. Dr. Nikoleta Mita is a professor at the University of Tirana

kombëtare, kërkime për lidhjen e vlerësimeve kombëtare me vlerësimet ndërkombëtare. Kjo parashtrësë krahasuese besohet të shërbejë si një mundësi që u jepet politikëbërësve, specialistëve dhe personelit arsimor në Kosovë për të rishikuar politikën e vlerësimit kombëtar me synim për të përmirësuar cilësinë e arsimit parauniversitar, për ta përafuar modelin e sistemit të vlerësimit arsimor kombëtar me modelet më të përparuara bashkëkohore, për të integruar elemente inovative në vlerësimin arsimor kombëtar, për ta institucionalizuar si sistem dhe për të skicuar zhvillimin perspektiv të tij.

Fjalët kyçe: vlerësim arsimor kombëtar, politikë e vlerësimit arsimor, model i vlerësimit arsimor kombëtar, vlerësim arsimor ndërkombëtar, sigurim i cilësisë në arsim.



Biografia

Profesoreshë në Universitetin e Tiranës, bashkëpunëtoreshë e jashtme e Universitetit Clemson (SHBA), e Universitetit të Prishtinës (Kosovë) dhe e Universitetit të Evropës Juglindore (Maqedoni e Veriut). Ka një përvojë 46-vjeçare në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit, në fushën e

assessment, research on linking national assessments with international assessments. This comparative study is believed to serve as an opportunity for policy makers, specialists and educational personnel in Kosovo to review the national assessment policy with the aim of improving the quality of pre-university education, aligning the model of the national educational assessment system with the most contemporary advanced models, to integrate innovative elements in the national educational assessment, to institutionalize it as a system and to outline its prospective development.

Keywords: national educational assessment, educational assessment policy, national educational assessment model, international educational assessment, quality assurance in education.

Prof. dr. Nikoleta Mita

Biography

Professor at the University of Tirana and external collaborator of Clemson University (USA), the University of Prishtina (Kosovo) and the South East European University (North Macedonia). She has 46 years of teaching and research experience in the fields of pedagogy, psychology, social

pedagogjisë, të psikologjisë, të shkencave sociale dhe të gjuhësisë. Ka dhënë kontribut në zhvillimin e fushës së vlerësimit arsimor dhe psikologjik në Shqipëri. Ka mbajtur pozicione drejtuese në institucione të arsimit të lartë. Ka një përvojë të pasur në planifikimin, organizimin dhe drejtimin e projekteve të kërkimit në fushën e arsimit dhe të shkencave sociale. Ka një kontribut aktiv në zhvillimin e reformave arsimore të të gjitha niveleve në Shqipëri dhe në Kosovë. Ka një përvojë të pasur në bashkëpunimet ndërkombëtare në fushën e arsimit dhe të psikologjisë. Ka drejtuar, ka koordinuar dhe ka marrë pjesë në disa projekte ndërkombëtare të fushës së arsimit. Është anëtare e disa shoqatave profesionale ndërkombëtare të fushës së edukimit dhe e bordeve të botimit të revistave. Ka botime të shumta në fushën e pedagogjisë.

sciences and linguistics. She has contributed to the development of the field of educational and psychological assessment in Albania. She has held leadership positions in higher education institutions. She has a wealth of experience in planning, organizing and directing research projects in the field of education and social sciences. She has actively contributed to the development of educational reforms at all levels in Albania and Kosovo. She has a rich experience of international cooperation in the field of education and psychology. She has directed, coordinated and participated in several international projects in the field of education. She is a member of several international professional associations in the field of education and magazine publishing boards. She has numerous publications in the field of pedagogy.

POLITIKAT DHE PRAKTIKAT E ZHVILLIMIT TË MËSIMDHËNËSVE NË KOSOVË: DILEMA MES PËRCJELLJES SË TRENDEVE DHE ADRESIMIT TË KONTEKSTIT LOKAL

TEACHER DEVELOPMENT POLICIES AND PRACTICES IN KOSOVO: THE DILEMMA BETWEEN FOLLOWING TRENDS AND CONSIDERING THE LOCAL CONTEXT

Blerim Saqipi⁵

Abstrakt

Përvoja e Kosovës në vlerësimet ndërkombëtare deri më tani ka qenë e drejtuar më shumë në rangimin në tabelë sesa në procesimin e rezultateve për politikat arsimore, qoftë në dimensionin e organizimit të shkollave, në zhvillimin e kurrikulave, apo në zhvillimin e mësimitdhënësve. Zhvillimi i mësimitdhënësve në vetvete paraqet një nënsektor të rëndësishëm, që ka edhe dimensionet rrethore, të cilat përbëjnë një sfidë për institucionet që kanë përgjegjësi zhvillimin e mësimitdhënësve. Këto rrethana konsistojnë në faktin që sistemi i arsimit funksion si tërësi dhe përgatitja e mësimitdhënësve varet edhe nga cilësia e kandidatëve që mësojnë profesionin e mësuesisë, cilësinë e përgatitjes gjatë studimeve, dhe menaxhimi i performancës së të diplomuarve gjatë tranzicionit në vendin e punës. Përgatitja e mësimitdhënësve në institucionet e arsimit të lartë është duke kaluar nëpër tranzicionin e nevojshëm dhe po i menaxhon tensionet që shkaktohen gjatë zhvillimit të një profesionalizmi të ri, e që do të realizohet me suksesin e duhur nëse vendoset si fokus i reformës së arsimit parauniversitar. Pjesëmarrja e Kosovës në vlerësime ndërkombëtare duhet të vazhdojë me një projektim më të precizuar rreth politikave nënsektoriale, duke i përkthyer ato në projekte të

Abstract

Kosovo's experience in international assessments so far has been directed more at ranking in the table than at processing the results for educational policies, either in the dimension of school organization, development of curricula, or teacher development. Teacher development in itself represents an important sub-sector, which also has circumstantial dimensions, constituting a challenge for the institutions that are responsible for the development of teachers. These circumstances consist in the fact that the functioning of the education system as a whole and the teacher training also depends on the quality of candidates who pursue the teaching profession, the quality of preparation during studies, and the management of the performance of graduates during the transition to the workplace. Teacher training in higher education institutions is going through the necessary transition and is managing the tensions that are caused during the development of a new professionalism, which will be realized with the appropriate success if it is set as the focus of the pre-university education reform. Kosovo's participation in international assessments should continue with a more precise design around sub-sectoral policies, translating them into specific

⁵ Dr. Blerim Saqipi është profesor dhe dekan në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës
Dr. Blerim Saqipi is a university professor and dean of the Faculty of Education, University of Prishtina

caktuara dhe duke ndërprerë fokusin në rangim. Ky prezantim jep disa ide rreth nevojës së zhvillimit të politikave të zhvillimit të mësimdhënësve në vijën e performancës së Kosovës në vlerësimet ndërkombëtare.

Fjalët kyçe: zhvillimi i mësimdhënësve, vlerësimet ndërkombëtare, profesionalizmi i mësimdhënësve.



Biografia

Mësimdhënës i politikave arsimore në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës. Ka përfunduar studimet e doktoratës në fushën e zhvillimit të profesionalizmit të mësimdhënësve në kontekst të zbatimit të reformës kurrikulare në Universitetin e Jyvaskyllas në Finlandë. Aktualisht është dekan i Fakultetit të Edukimit dhe fusha e tij e hulumtimit është zhvillimi i politikave arsimore në raport me kontekstin social dhe profesional, si dhe specifikat e zhvillimit të profesionalizmit të mësimdhënësve dhe shkollës si organizatë.

projects and ceasing the focus on ranking. This presentation gives some ideas about the need to develop teacher development policies in line with Kosovo's performance in international assessments.

Keywords: teacher development, international assessment, teacher professionalism.

Prof. asoc. dr. Blerim Saqipi

Biography

Teacher of educational policies at the Faculty of Education of the University of Prishtina. He completed his doctoral studies in the field of the teacher's professional development in the context of the implementation of the curriculum reform at the University of Jyvaskylla in Finland. He is currently the dean of the Faculty of Education and his field of research is the development of educational policies in relation to the social and professional context, as well as the specifics of the professional development of teachers and of the school as an organization.

REZULTATET E TESTIMEVE PISA DHE PIRLS KRAHASUAR ME REZULTATET E STUDIMEVE TË KRYERA NË TERREN

THE RESULTS OF THE PISA AND PIRLS TESTS COMPARED TO RESULTS FROM FIELD STUDIES

Murteza Osdautaj⁶

Abstrakt

Rezultatet e dy testimeve ndërkombëtare, PISA dhe PIRLS, nuk ishin pa ndikim të vërejtur në shkollat tona dhe sidomos në opinionin publik, shkencor dhe politik. Treguesit e dalë nga testimet PISA 2018 dhe 2021, si dhe në PIRLS 2022, treguan një situatë të rëndë në fushën e kulturës së leximit, në grupmoshat e nxënësve 10-vjeçar dhe të atyre 15-vjeçar.

Për t'i hulumtuar shkaqet e këtyre rezultateve të dobëta, kemi bërë një analizë të përgjithshme të rezultateve të këtyre tri testimeve, si dhe kemi zhvilluar tri hulumtime në terren, për t'i hulumtuar disa aspekte mësimore dhe kurrikulare, për të cilat kemi menduar se mund të jenë faktorë kyçë në zhvillimin e kulturës së leximit të nxënësit kosovarë dhe sidomos të atyre që, sipas standardeve, testohen në këto testime ndërkombëtare.

Nga analiza e rezultateve, kemi parë se dallimi në mes të rezultateve të arrira në dy testimet PISA janë të dobëta dhe nuk kanë shënuar rritje sinjifikative. Dallimi në mes të rezultateve të arrira në PISA dhe në PIRLS është përafërsisht i njëjtë dhe, në të dyja këto testime, radhitja e vendit tonë është, në të dy rastet, në fund të listës.

Analiza ka treguar se probleme në kulturën e leximit kanë nxënësit, probleme në kulturën e leximit kanë mësimdhënësit dhe probleme

Abstract

The results of the two international tests, PISA and PIRLS, were not without an impact observed in our schools and especially in the public, scientific and political opinion. The indicators from the PISA 2018 and 2021 tests, as well as PIRLS 2022, showed a serious situation in the field of reading culture, in the age groups of 10-year-old and 15-year-old students.

In order to investigate the causes of these poor results, we have made a general analysis of the results of these three tests, and we have developed three research studies in the field, to investigate some teaching and curriculum aspects, which we thought can be key factors in the development of the reading culture of Kosovar students and especially those who, according to the standards, are tested in these international tests.

The analysis of the results showed that the difference between the results achieved in the two PISA tests are poor and have not marked a significant increase. The difference between the results achieved in PISA and in PIRLS is approximately the same and, in both these tests, our country's ranking is, in both cases, at the bottom of the list.

⁶ Dr. Murteza Osdautaj është hulumtues në IPK
Dr. Murteza Osdautaj is a researcher at KPI

tematike kanë edhe tekstet mësimore dhe kurrikulat bazë dhe ato lëndore. Po kështu, rezultatet e studimeve, qoftë nga analiza e rezultateve të arritura, qoftë nga të dhënat e mbledhura në terren, kanë treguar se problemet shtrihen që nga familja e deri te menaxhmenti i shkollës dhe në sistemin e aftësimit profesional të arsimtarëve në fakultet dhe me anë të trajnimeve. Të dhënat kanë treguar se për pesë vjet mësuesit, mesatarisht, kanë ndjekur më shumë se pesë milionë orë trajnimesh, 78% e nxënësve nuk kanë lexuar asnjë libër, gjuha e përdorur në shkollë, në 40% të orëve mësimore, nuk është gjuha standarde. Gjithashtu, studimi ka treguar se familja kosovare ende nuk është e diferencuar në aspektin socio-ekonomik dhe kulturor, ndërsa që 52% e arsimtarëve kanë njohuri për testimet ndërkombëtare vetëm nga të dhënat që kanë arritur t'i lexojnë në gazeta dhe portale. Po kështu, nga studimi kemi arritur të konstatojmë se qasja e arsimtarëve, e shkollave dhe e komunave, ndaj rëndësisë së PISA-s dhe PIRLS-it ka qenë neglizhuese, me çka është ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rezultatet në testim dhe në pasaktësinë e të dhënave të tjera të kërkuara me rastin e testeve.

Punimi mëton të përshkruajë dhe të paraqesë një varg masash që duhet të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes.

Fjalët kyçe: testimet ndërkombëtare, PISA, PIRLS, rezultatet, nxënësit, mësuesit, kurrikulat lëndore, udhëheqja e shkollave.

The analysis has shown that the students have problems in the reading culture, the teachers have problems in the reading culture, and the textbooks and the basic and subject curricula also have thematic problems. Likewise, the results of the studies, either from the analysis of the results achieved, or from the data collected in the field, have shown that the problems extend from the family to the school management and the system of professional teacher training in the faculty and with part of the trainings. Data have shown that for five years, teachers, on average, have attended more than five million hours of training, 78% of students have not read any books, the language used in school, in 40% of lessons, is not the standard language. Also, the study has shown that the Kosovar family is still not differentiated in socio-economic and cultural terms, while 52% of teachers have knowledge about international tests only from the data they have managed to read in newspapers and portals. Likewise, from the study we have managed to establish that the approach of teachers, schools and municipalities to the importance of PISA and PIRLS has been negligent, which has directly affected the test results and the inaccuracy of other data required in the case of tests.

The paper tries to describe and present a series of measures that should be taken to improve the situation.

Keywords: international testing, PISA, PIRLS, results, students, subject curricula, school leadership.



Dr. Murteza Osdautaj

Biografia

Murteza Osdautaj është punëtor shkencor në Institutin Pedagogjik të Kosovës. Studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe (bachelor, magjistraturë dhe doktoratë) i ka kryer në Universitetin e Prishtinës. Një titull tjetër të magjistratit të shkencave e ka marrë në fushën e edukimit special si dhe ka kryer dy specializime dyvjeçare për rrjetat dhe aplikacionet kompjuterike. Gjatë karrierës ka punuar mësues, këshilltar pedagogjik, ekspert arsimor në Drejtorinë e Arsimit në Deçan, profesor universitar, si dhe ka punuar në Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, në pozitën e drejtorit të Departamentit të Shkencës dhe Teknologjisë. Përvoja e tij është e lidhur me hartimin e politikave arsimore, dokumenteve strategjike, legjisllacionin arsimor, poezinë, studimet në fushën e letërsisë, si dhe hulumtimet në fushën e arsimit special.

Biography

Murteza Osdautaj is a researcher at the Pedagogical Institute of Kosovo. He completed his studies in literature and Albanian language (bachelor's, master's and doctorate) at the University of Pristina. He received another master of science degree in the field of special education and completed two two-year specializations in computer networks and applications. During his career, he worked as a teacher, pedagogical advisor, educational expert in the Directorate of Education in Deçan, university professor, as well as worked in the Ministry of Education, Science and Technology, in the position of director of the Department of Science and Technology. His experience is related to the drafting of educational policies, strategic documents, educational legislation, poetry, studies in the field of literature, as well as research in the field of special education.

SISTEMI AKTUAL I VLERËSIMEVE KOMBËTARE

THE CURRENT NATIONAL ASSESSMENT SYSTEM

Avni Rexha⁷ & Fatmir Elezi⁸

Abstrakt

Në arsimin parauniversitar në Kosovë aktualisht janë 3 lloje të vlerësimit të nxëniet: Vlerësimi i brendshëm, Vlerësimi i jashtëm dhe Vlerësimi ndërkombëtar. Gjatë arsimit parauniversitar, vlerësohen progresi i vazhdueshëm dhe niveli i arritjeve të rezultateve të të nxëniet, siç përcaktohen me Kornizën Kurrikulare të Kosovës, Kurrikulën Bërthamë për shkallët kryesore të Kurrikulës, Programet dhe planet mësimore të lëndës. Procesi i vlerësimit, bazuar në Kornizën Kurrikulare të Kosovës, është i orientuar te Vlerësimi i brendshëm dhe Vlerësimi i jashtëm. Vlerësimi i brendshëm ose Vlerësimi me bazë në shkollë synon të mbështesë dhe të forcojë të nxëniet dhe raportimin e rregullt të përparimit individual të nxënësve. Vlerësimi i jashtëm, nga ana tjetër, është një vlerësim i standardizuar për të matur nivelin e arritjeve të rezultateve të të nxëniet, zotërimin e kompetencave në fund të niveleve I, II dhe III të arsimit parauniversitar.

Vlerësimet kryesore të nxënësve në arsimin parauniversitar janë Testi i Arritshmërisë dhe Provimi i Maturës Shtetërore.

Si konkluzion del se vlerësimet për nxënësit në arsimin parauniversitar bëhen duke u bazuar në

Abstract

There are currently 3 types of learning assessment in pre-university education in Kosovo: internal assessment, external assessment and international assessment. During pre-university education, continuous progress and the level of achievement of learning outcomes are assessed, as determined by the Kosovo Curriculum Framework, the Core Curriculum for the main levels of the Curriculum, the Programmes and lesson plans of the subject. The assessment process, based on the Kosovo Curriculum Framework, is oriented towards internal assessment and external assessment. Internal Assessment or School Based Assessment aims to support and strengthen learning and regular reporting of individual student progress. External assessment, on the other hand, is a standardized assessment to measure the level of achievement of learning outcomes, mastery of competences at the end of levels I, II and III of pre-university education.

The main student assessments in pre-university education are the Achievement Test and the State Matura Exam.

In conclusion, it appears that student assessments in pre-university education are based on the

⁷ Dr. Avni Rexha është drejtor i Departamentit të arsimit parauniversitar në MASHTI
Dr. Avni Rexha is Director of the Department of Pre-University Education at MESTI

⁸ Fatmir Elezi është udhëheqës divizioni në MASHTI
Fatmir Elezi is Head of Division at MESTI

Kornizën Kurrikulare të Kosovës, Kurrikulën Bërthamë për shkallët kryesore të Kurrikulës, Programet dhe planet mësimore të lëndës.

Kosova, gjithashtu, që nga viti 2012, merr pjesë në vlerësimet ndërkombëtare, në të cilat, në një nivel kombëtar, vlerësohen kompetencat dhe aftësitë e nxënësve (PISA/ 2015 – 2018 – 2021, TIMSS/2019, PIRLS/2022).

Fjalët kyçe: arsim, kurrikula, vlerësim, mësimdhënës, nxënës.

Kosovo Curriculum Framework, the Core Curriculum for the main levels of the Curriculum, the Programs and lesson plans of the subject.

Additionally, since 2012, Kosovo participates in international assessments which assess student competences and abilities at a national level (PISA/ 2015 – 2018 – 2021, TIMSS/2019, PIRLS/2022).

Keywords: education, curricula, assessment, teacher, student.

**SI MUND TË NDIKOJNË GJETJET NGA
PROCESI I NGRITJES SË MODELIT TË
SIGURIMIT TË CILËSISË I UDHËHEQUR
NGA KOLEGËT KOSOVARË NË CILËSINË
E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE NË
KOSOVË**

**HOW FINDINGS FROM THE KOSOVAN
PEER LED QUALITY ASSURANCE MODEL
BUILDING PROCESS CAN INFLUENCE
THE QUALITY OF STUDENT
ASSESSMENT IN KOSOVO**

Robert Blease⁹

Abstrakt

Modeli i sigurimit të cilësisë në vlerësimin e udhëhequr nga kolegët kosovarë është program i ngritjes së kapaciteteve që është integruar në tërë Kosovën, si rezultat i projektit KOSED, të financuar nga BE-ja. Qëllimi i tij është t'iu ndihmojë të gjithë mësimitdhënësve të identifikojnë më mirë mësimitdhënien dhe nxënien e cilësisë së lartë, duke përfshirë reflektimin mbi praktikën e vlerësimit. Modeli i udhëhequr nga kolegët i aftëson mësimitdhënësit të mbledhin dhe t'i vërtetojnë dëshmitë nga një varg burimesh për të marrë vendime më të mira. Po ashtu, prodhon një sasi të madhe të dhënash cilësore, që mund të përdoren për t'i identifikuar prioritetet e arsimit anembanë Kosovës. Përmes integritit të tij, në mbi 100 shkolla në Kosovë, janë mbledhur të dhëna për një mori çështjesh, duke përfshirë të dhëna rreth zbatimit të praktikave të vlerësimit në shkolla. Modeli i sigurimit të cilësisë, i udhëhequr nga kolegët kosovarë, ngërthen në vetvete parimet e transparencës dhe kolegialitetit, duke promovuar një mjedis jo paragjykes, që e nxit rritjen profesionale. Duke krijuar një politikë me dyer të

Abstract

The Kosovan peer-led evaluation quality assurance model is capacity building program that is being introduced across Kosova as a result of the EU funded KOSED project. It aims to help all educators to better identify high quality teaching and learning, including reflection upon assessment practices. The peer led model trains educators to collect and triangulate evidence from a range of sources to better inform decision making. It also produces a great deal of qualitative data that can be used to help identify education priorities across Kosova. Its introduction in over 100 schools in Kosova has collected data on a range of issues, including data on the implementation of assessment practices in schools. The Kosovan peer led quality assurance model embodies the principles of transparency and collegiality, fostering a non-judgmental environment conducive to professional growth. By establishing an open-door policy to classroom observation, educators are empowered to exchange best practices, while municipalities can identify systemic issues

⁹ Dr. Robert Blease, ekspert nga projekti EU-KosED
Dr. Robert Blease, expert from EU-KosED project

hapura për vëzhgimin në klasë, mësimdhënësit fuqizohen t'i këmbëjnë praktikën e mirë, ndërsa komunitetet mund t'i identifikojnë çështjet sistematike që kërkojnë ndërhyrje. Modeli e rrit vetëdijësimin e mësimdhënësve dhe ofron dëshmi të zbatimit të vlerësimit formativ dhe përmbledhës nëpër shkollat e Kosovës. Ky prezantim është hyrje në modelin e sigurimit të cilësisë i udhëhequr nga kolegët kosovarë. Do të shpjegohet se si funksionon, do të diskutohet suksesi i tij dhe gjetjet kryesore nga puna në mbi 100 shkolla në Kosovë. Gjatë prezantimit do të jepen dëshmi cilësore nga vizitat në shkolla, si dhe dëshmi anekdotale nga terreni, që e ilustron statusin e vlerësimit të nxënësve në Kosovë. Këto dëshmi do të përdoren për të ofruar këshilla praktike rreth mënyrës se si mund të përmirësohet cilësia e vlerësimit të nxënësve.

Fjalët kyçe: i udhëhequr nga kolegët, sigurimi i cilësisë, vlerësimi i nxënësve, vëzhgimi në klasë.

warranting intervention. It raises teacher awareness and provides evidence of the implementation of formative and summative assessment throughout schools in Kosovo. This presentation is an introduction to the Kosovan peer led quality assurance model. It will explain how it worked, discuss its success and relate key findings from work in over 100 schools in Kosovo. The presentation will share qualitative evidence from school visits, and anecdotes from the field that exemplify the status of student assessment in Kosovo and use this evidence suggestions to offer practical advice on how the quality of student assessment can be improved.

Keywords: peer led, quality assurance, student assessment, classroom observation.

VLERËSIMET NË SHKALLË TË GJERË KARSHI DILEMAVE TË MËSIMDHËNËSVE PËR PËRMIRËSIMIN E PRAKTIKËS SË TYRE NË KLASË

LARGE-SCALE ASSESSMENTS VERSUS TEACHERS' DILEMMAS IN IMPROVING THEIR CLASSROOM PRACTICE

Mihaela Singer¹⁰, Armend Shabani¹¹, Dije Shatri, Fadil Latifi¹², Osman Buleshkaj¹³

Abstrakt

Vlerësimet në shkallë të gjerë përfshijnë testimet kombëtare, të cilave të gjithë nxënësit nga një nivel i caktuar i arsimit duhet t'u nënshtrohen për të kaluar në studime të mëtejshme. Nga kjo perspektivë, vlerësimet në shkallë të gjerë, në mënyrë të pashmangshme, kanë ndikim në politikën arsimore, kurrikulën, praktikën në klasë dhe karrierën individuale të nxënësve. Vlerësimet në shkallë të gjerë, që përfshijnë studimet krahasimore (siç janë PISA, TIMSS dhe PIRLS), duhet të ofrojnë mbështetje të bazuar në dëshmi për t'i orientuar politikën arsimore, kurrikulën dhe praktikën në klasë drejt zhvillimit të disa kompetencave të nxënësve në botën globale. Diskutimet do ta hulumtojnë marrëdhënien mes vlerësimeve kombëtare (Semimatura dhe Matura), që përdoren si mjete orientimi për nxënësit dhe metodat e vlerësimit që i adresojnë kompetencat e nxënësve për jetë dhe punë. Do të adresohen një mori pyetjesh, në mesin e së cilave: Si ndikojnë këto teste në praktikën në klasë? A duhet të

Abstract

Large-scale assessments include national examinations that all students from a certain level of education must take in order to progress to further studies. From this perspective, large-scale assessments inevitably have an impact on educational policy, curriculum, classroom practice, and individual student's careers. Large-scale assessments that involve comparative studies (such as PISA, TIMSS, and PIRLS) should offer evidence-based support for orienting educational policy, curriculum, and classroom practice toward the development of certain competencies of students in a global world. The discussions will explore the relationship between national assessments ("Semi matura" and "Matura") that are used as orientation means for the students and the assessment methods that address students' competencies for life and work. A variety of questions will be addressed, among which: How do these tests impact classroom practices? Should

¹⁰ Dr. Mihaela Singer, eksperte nga projekti EU-KosED

Dr. Mihaela Singer, expert from EU-KosED project

¹¹ Dr. Armend Shabani, profesor në Fakultetin e Shkencave Matematike

Dr. Armend Shabani, professor at the Faculty of Mathematical Sciences

¹² Dr. Fadil Latifi, mësimdhënës dhe hulumtues

Dr. Fadil Latifi, teacher and researcher

¹³ Dr. Osman Buleshkaj, bashkëpunëtor shkencor në IPK

Dr. Osman Buleshkaj, associate researcher at KPI

përqendrohen mësimdhënësit në përgatitjen e nxënësve për këtë lloj vlerësimi për t'iu ndihmuar atyre të performojnë mirë dhe t'i "mbijetojnë" sistemit, apo ta aplikojnë një qasje më holistike dhe gjithëpërfshirëse? Pasi që këto vlerësime kombëtare janë përtej studimeve krahasimore ndërkombëtare, ku dhe si mund ta gjejmë ekuilibrin? Panelistët do të diskutojnë aspekte të ndryshme lidhur me ndërhyrjet e mësipërme dhe do t'i propozojnë disa strategji për përditësimin e praktikave të vlerësimit në Kosovë.

Fjalët kyçe: vlerësimi në shkallë të gjerë, dilemat e mësimdhënësve, praktika në klasë, politika arsimore.

the teachers focus on preparing students for this kind of assessment to help them perform well and "survive" the system, or apply a more holistic and comprehensive approach? As these national assessments are far beyond international comparative studies, where and how could we find a balance? The panelists will discuss various aspects related to the above interferences and propose some strategies for updating the assessment practices in Kosovo.

Keywords: large-scale assessment, teacher dilemmas, classroom practice, educational policy.

Sesionet paralele/Parallel Sessions

TEMA 1. SISTEMI AKTUAL I VLERËSIMEVE KOMBËTARE
TOPIC 1. CURRENT SYSTEM OF NATIONAL ASSESSMENTS

VLERËSIMET KOMBËTARE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË DHE (MOS)BALLAFAQIMI ME VLERËSIMET NDËRKOMBËTARE

NATIONAL ASSESSMENTS IN PRE- UNIVERSITY EDUCATION IN KOSOVO AND (NON)CONFRONTATION WITH INTERNATIONAL ASSESSMENTS

Fatmir Fejziu¹⁴

Abstrakt

Në këtë kumtesë do të trajtohet rëndësia e organizimit të vlerësimeve kombëtare në sistemin parauniversitar në Kosovë, të arriturat, mangësitë dhe sfidat e sistemit aktual të këtyre vlerësimeve. Përmes metodës së analizës teorike, praktike dhe statistikore, do të nxirren të dhëna konkrete nga vlerësimet e standardizuara shtetërore, sidomos për testin e arritshmërisë; do të analizohet ndikimi që kanë këto vlerësime në arritjen e rezultateve të nxënësve dhe përmes paraqitjes së rezultateve reale do të vihet në pah performanca e nxënësve dhe e sistemit arsimor parauniversitar në përgjithësi. Pavarësisht që tema është shumë-dimensionale, sepse vlerësimet kombëtare përfshijnë disa fusha kurrikulare të vlerësimit, kjo temë synon të përfshijë të dhëna të sakta e të nevojshme për sistemin e vlerësimit, sfidat me të cilat ballafaqohet ky sistem dhe qasjen që duhet ndjekur për përmirësimin e këtyre vlerësimeve, si dhe ballafaqimin me vlerësime ndërkombëtare. Qasja kërkimore do të identifikohet si studim i përgjithshëm sasior dhe cilësor. Metodatat e përdorura për mbledhjen e të dhënave do të përfshijnë rezultatet e nxënësve në testet e arritshmërisë dhe të PISA-s, analizën e

Abstract

This presentation will address the importance of organizing national assessments in the pre-university system in Kosovo, achievements, shortcomings and challenges of the current system of these assessments. Through the method of theoretical, practical and statistical analysis, concrete data will be extracted from the standardized state assessments, especially for the achievement test; the impact that these assessments have on achieving student results will be analysed and through the presentation of real results the performance of students and the pre-university education system in general will be highlighted. Despite the fact that the topic is multidimensional, because national assessments include several curricular areas of assessment, this topic aims to include accurate and necessary data about the assessment system, the challenges the system faces and the approach to be adopted to improve these assessments, as well as dealing with international assessments. The research approach will be identified as general quantitative and qualitative research. The methods used for data collection will include students' results in

¹⁴ MA Fatmir Fejziu, PhDc, është mësimpldhënës i Gjuhës shqipe në ShFMU "Mehmet Gjevori", Prishtinë
fatmirfejziu78@gmail.com

MA Fatmir Fejziu, PhDc, teacher of Albanian Language, Mehmet Gjevori school, Prishtinë fatmirfejziu78@gmail.com

dokumenteve si dhe intervistimin. Mostër për studim do të jenë nxënësit pjesëmarrës në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Rezultatet dhe konkluzionet e nxjerra do të orientojnë rrugën që duhet ndjekur për ndryshime të nevojshme, si dhe do të orientojnë ballafaqimin me vlerësimet ndërkombëtare, si PISA, TIMSS dhe PIRLS, në të cilat aktualisht merr pjesë Kosova.

Fjalët kyçe: vlerësim, politikë arsimore, menaxhim, sfidë, rezultat.

achievement tests and PISA, document analysis and interviewing. The sample for the study will be students participating in national and international assessments. The results and conclusions drawn will guide the way to be followed for necessary changes, as well as guide the confrontation with international assessments, such as PISA, TIMSS and PIRLS, in which Kosovo currently participates.

Keywords: assessment, educational policy, management, challenge, result.

(JO)KOHERENCA E KURRIKULËS DHE VLERËSIMIT NË SISTEMIN ARSIMOR NË KOSOVË

(IN)COHERENCE OF THE CURRICULUM AND ASSESSMENT IN THE EDUCATIONAL SYSTEM IN KOSOVO

Xhavit Rexhaj¹⁵

Abstrakt

Ka kaluar një çerek shekull prej luftës dhe arsimit në Kosovë, sipas të gjithë indikatorëve, ende nuk po arrin të tregojë shenja rikuperimi, përmirësimi e konsolidimi. Të gjithë treguesit e rëndësishëm ndërkombëtarë në fushën e arsimit, si Indeksi i Zhvillimit Human (HDI), Indeksi i Kapital Njerëzor (HCI), dhe testet e standardizuara ndërkombëtare (PISA, TIMMS, PIRLS), i vendosin Kosovën dhe arsimin kosovar nga fundi ose fare në fund të listës së vendeve. Në anën tjetër, testet e standardizuara vendore, rezultatet nga vlerësimi i brendshëm, por edhe deklaratimet e pjesëmarrësve vendorë në procesin arsimor, japin një pasqyrë pothuajse të kundërt me atë që indikohet në burimet ndërkombëtare. Domethënë, arsimi kosovar funksionon ose në kundërshti të plotë me kriteret e treguesit ndërkombëtarë ose brenda arsimit kosovar ka një çarje ose tërheqje centrifugale në mes të dimensioneve kryesore të procesit arsimor. Në kërkim të kësaj çarjeje, dhe në pamundësi të shqyrtimit të faktorëve e dimensioneve kryesore (mësimdhënies, mjeteve materiale, mjediseve arsimore, teksteve shkollore, prindërve, sistemit të sigurimit të cilësisë etj.), ky punim ka shikuar raportin në mes të (i) kurrikulës kosovare të bazuar në kompetenca (respektivisht rezultateve të saj kryesore), (ii) natyrës së testeve të standardizuara

Abstract

A quarter of a century has passed since the war, and education in Kosovo, according to all indicators, still fails to show signs of recovery, improvement and consolidation. All important international indicators in the field of education, such as the Human Development Index (HDI), the Human Capital Index (HCI), and the international standardized tests (PISA, TIMMS, PIRLS), place Kosovo and Kosovar education at the bottom or at the very bottom of the list of countries. On the other hand, the local standardized tests, the results from the internal assessment, but also the statements of the local participants in the educational process, give an overview almost opposite to what is indicated in the international sources. That is, Kosovar education works either in complete contradiction with the criteria of international indicators or within Kosovar education there is a rift or centrifugal attraction between the main dimensions of the educational process. In search of this gap, and in the impossibility of examining the factors of the main dimensions (teaching, material tools, educational environments, textbooks, parents, quality assurance system, etc.), this paper has looked at the relationship between (i) the Kosovar competence-based curriculum (respectively its main results), (ii) the

¹⁵ Dr. Xhavit Rexhaj është profesor në AAB xhavitr@hotmail.com
Dr. Xhavit Rexhaj is a professor at AAB xhavitr@hotmail.com

ndërkombëtare, (iii) natyrës së testeve të standardizuara vendore, dhe (iv) pjesërisht mënyrës së vlerësimit të brendshëm të nxënësve nga mësimdhënësit në shkolla. Nga rezultatet preliminare të hulumtimit kemi mësuar se procesi arsimor në Kosovë vuan nga jokoherenca dhe kakofonia thelbësore dhe se çarja ose forcat centrifugale që veprojnë më fuqishëm në procesin arsimor në Kosovë habitojnë pikërisht në gjirin e kurrikulës, përfshirë më konkretisht metodologjinë e mësimdhënies, vlerësimin (përfshirë atë të jashtëm), dhe rezultatet kryesore të kurrikulës. Të gjitha këto kundërshtohen në mes veti si forca shtytëse në drejtime të kundërta dhe pastaj të gjitha së bashku kundërshtohen me trendët dhe qasjet ndërkombëtare, në rastin konkret të vlerësimit të standardizuar (në formë të PISA, TIMMS dhe PIRLS). Kjo paraqet përdorim tejet joefikas të resurseve materiale e njerëzore (mësimdhënësve) dhe njëkohësisht një mjedis stresues dhe joproduktiv për nxënësit në arsimin kosovar.

Fjalët kyçe: kurrikula, vlerësimi i standardizuar, koherenca, PISA, matura.

nature of international standardized tests, (iii) the nature of local standardized tests, and (iv) partly the way of internal assessment of students by teachers in schools. From the preliminary results of the research, we have learned that the educational process in Kosovo suffers from essential incoherence and cacophony, and that the rift or centrifugal forces that operate most strongly in the educational process in Kosovo are surprising precisely in the curriculum, including more specifically the teaching methodology, assessment (including the external one), and the main outcomes of the curriculum. All of these are opposed among themselves as driving forces in opposite directions and then all together are opposed with international trends and approaches, in the specific case of standardized assessment (in the form of PISA, TIMMS and PIRLS). This represents a very inefficient use of material and human resources (teachers) and at the same time a stressful and unproductive environment for students in the Kosovar education.

Keywords: curriculum, standardized assessment, coherence, PISA, matura.

SFIDAT E VLERËSIMIT KOMBËTAR TË NXËNËSVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

CHALLENGES OF NATIONAL ASSESSMENT OF STUDENTS WITH SPECIAL NEEDS IN PRE-UNIVERSITY EDUCATION

Lirije Vitija Reçica¹⁶ & Blerina Halilaj¹⁷

Abstrakt

Ky hulumtim ka për qëllim të identifikojë nivelin dhe sfidat e përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore (NVA) në vlerësimet kombëtare. NVA ligjërisht gëzojnë të gjitha të drejtat, sikurse nxënësit e tjerë, andaj arsimimi i NVA nënkupton angazhim shtesë edhe vlerësim sipas kriterëve që u përshtatën nevojave të tyre specifike. Qasja hulumtuese cilësore është zbatuar për grumbullimin e të dhënave, ndërsa intervista si metodë eksploruese dhe përshkruese. Mostra e hulumtimit përfshin gjithsej 9 pjesëmarrës nga niveli qendror, lokal dhe në nivel të institucioneve shkollore. Instrumentet e hulumtimit, të përdorura në këtë hulumtim, janë protokoli i intervistës dhe listë e kontrollit për analizën e dokumenteve. Rezultatet e hulumtimit tregojnë që disa nxënës me NVA marrin pjesë në vlerësimet kombëtare, por për nivelin e përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në vlerësimet kombëtare nuk ka të dhëna zyrtare në nivel të vendit. Sipas raportimeve të të gjithë aktorëve të përfshirë në hulumtim, nxënësit që marrin pjesë në vlerësimet kombëtare u nënshtrohen testeve të standardizuara, sikur të gjithë nxënësit e tjerë, pa

Abstract

This study aims to identify the level and challenges of including students with special educational needs (SEN) in national assessments. SENs legally enjoy all the rights, like other students, therefore SEN education means additional commitment and assessment according to criteria adapted to their specific needs. The qualitative research approach was applied for data collection, while the interview as an exploratory and descriptive method. The research sample includes a total of 9 participants from the central, local and school institution levels. The research instruments used in this research are the interview protocol and the document analysis checklist. The results of the research show that some students with SEN participate in national assessments, but there is no official data on the level of inclusion of students with special educational needs in national assessments. According to the reports of all actors involved in the research, students who participate in national assessments are subjected to standardized tests like all other students, without suitable criteria or even conditions according to

¹⁶ MA Lirije Vitija Reçica është mësime dhënëse në QMBK "Përparimi" / lirjevitija@gmail.com

MA Lirije Vitija Reçica is a teacher at QMBK "Përparimi" / lirjevitija@gmail.com

¹⁷ MA Blerina Halilaj është psikologe në QMBK "Përparimi" / blerinahalilaj@gmail.com

MA Blerina Halilaj is a psychologist at QMBK "Përparimi" / blerinahalilaj@gmail.com

kritere të përshtatshme apo edhe kushte sipas nevojave dhe aftësive të tyre. Andaj, për një arsim të mirëfilltë gjithëpërfshirës rekomandojmë që të rishikohen legjislacioni dhe politikat në nivel vendi; të krijohet platforma /databaza për identifikim dhe evidentim të NVA, sipas llojit të aftësisë së kufizuar dhe nevojave të tyre për vlerësim; të modifikohen dhe të adaptohen format e vlerësimit kombëtar për NVA; të përfshihen ekspertë të fushës së aftësisë së kufizuar për të identifikuar praktikatat më të mira dhe modelet më efektive të gjithëpërfshirjes së NVA në testet kombëtare në nivel vendi.

Fjalët kyçe: nxënës me nevoja të veçanta, arsimi gjithëpërfshirës, vlerësimi kombëtar, sfidat e vlerësimit, teste të adaptuara.

their needs and abilities. Therefore, for a genuine comprehensive education we recommend that legislation and policies be reviewed at the country level; create a platform/database for identification and registration of SENs, according to the type of disability and their assessment needs; modify and adapt the national assessment forms for SENs; involve experts in the field of disability to identify best practices and the most effective models of inclusion of SEN in national tests at the country level.

Keywords: students with special needs, inclusive education, national assessment, assessment challenges, adapted tests.

PËRDORIMI I INSTRUMENTEVE TË DUHURA TË VLERËSIMIT TË NXËNËSVE DREJT PËRMIRËSIMIT TË TË NXËNIT DHE NGRITJES SË CILËSISË NË MËSIMDHËNIE

USING THE APPROPRIATE STUDENT ASSESSMENT INSTRUMENTS TO IMPROVE LEARNING AND INCREASE THE QUALITY OF TEACHING

Mimoza Hoti¹⁸

Abstrakt

Vlerësimi është padyshim pjesa më e ndjeshme dhe më e komplikuar në mësimdhënie. Për shumë mësimdhënës vlerësimi mund të jetë i barasvlershëm me punët dhe përgjegjësitë e tjera në profesionin që ushtrojnë, mirëpo jo rrallëherë gabojmë në këtë aspekt. Vlerësimi duhet të ndihmojë të nxënësit, të motivojë nxënësit si dhe t'i përgatisë ata për të ardhmen, drejt përmirësimit të njohurive dhe gjetjes së rrugës drejt suksesit. Prandaj, ky hulumtim identifikon rolin e përdorimit të instrumenteve të vlerësimit, të cilat i ndihmojnë nxënësit në të nxënësit dhe për një performancë më të mirë në testet kombëtare dhe ndërkombëtare, pasi që shkolla fillore është baza për edukimin e tyre në të ardhmen. Hulumtimi ynë është zhvilluar nëpërmjet dy metodave, sasiore dhe cilësore, dhe përfshin 10 shkolla të Prizrenit. Në hulumtim morën pjesë 40 mësimdhënës, 40 prindër dhe 80 nxënës të shkollave fillore. Instrumentet për mbledhjen e të dhënave janë intervistat dhe pyetësorët, të cilët u shpërndanë me anë të Google forms. Të dhënat e mbledhura janë analizuar me anë të programit SPSS. Gjetjet tregojnë se përdorimi i një numri të mjaftueshëm instrumentesh për matjen dhe vlerësimin e

Abstract

Assessment is undoubtedly the most sensitive and complicated part of teaching. For many teachers, assessment can be equivalent to other jobs and responsibilities in the profession they practice, but we are often wrong in this respect. Assessment should help learning, motivate students and prepare them for the future, towards improving knowledge and finding the path to success. Therefore, this research identifies the role of using assessment instruments, which help students in learning and performing better in national and international tests, since primary school is the basis for their future education. Our research was developed through two methods, quantitative and qualitative, and includes 10 schools in Prizren. 40 teachers, 40 parents and 80 primary school students participated in the research. The instruments for data collection are interviews and questionnaires, which were distributed through Google forms. The collected data were analysed using the SPSS programme. The findings show that using an adequate number of instruments for measuring and assessing students affects their performance in national and international tests.

¹⁸ Mimoza Hoti, shkolla fillore e mesme e ulët "Heronjtë e Lumës" - Vermicë, mimozahoti21@gmail.com
Mimoza Hoti, "Heronjtë e Lumës" Elementary and Lower Secondary School, Vermice, mimozahoti21@gmail.com

nxënësve ndikon në ngritjen e performancës së tyre në testet kombëtare dhe ndërkombëtare. Nga kjo arrijmë në përfundim se edhe hipoteza jonë: "Shkollat dhe mësime dhënësit janë përgjegjësit kryesorë për performancën e nxënësve" del të jetë e saktë. Prandaj, rekomandojmë që të përdoren sa më shumë instrumente të vlerësimit, të zhvishemi nga vlerësimi tradicional, dhe të ndërmerren hapa konkretë në përmirësimin e gjendjes së arsimit në Kosovë.

Fjalët kyçe: instrumentet, mësime dhënësit, nxënësit, shkolla, vlerësimi.

This leads us to the conclusion that our hypothesis: "Schools and teachers are the main responsible parties for the performance of students" turns out to be correct. Therefore, we recommend to use as many assessment instruments as possible, to get rid of traditional assessment, and to take concrete steps to improve the state of education in Kosovo.

Keywords: instruments, teachers, students, school, assessment.

PËRDORIMI I REZULTATEVE TË VLERËSIMEVE TË NXËNËSVE PËR PËRMIRËSIMIN E MËSIMDHËNIES DHE NXËNIES

USING STUDENT ASSESSMENT RESULTS TO IMPROVE TEACHING AND LEARNING

Selim Mehmeti¹⁹

Abstrakt

Vlerësimi i nxënësve dhe përdorimi i rezultateve të vlerësimit për qëllime të përmirësimit të mësimdhënies dhe nxënies është një temë me rëndësi të veçantë për studiuesit në Kosovë. Kosova ka disa vjet që krahas vlerësimit të brendshëm të nxënësve, në nivel shkolle, organizon edhe vlerësime kombëtare të rregullta në arsimin parauniversitar. Gjithashtu, Kosova nga viti 2015 merr pjesë në vlerësimet ndërkombëtare, si PISA (2015, 2018 dhe 2022), TIMSS (2019) dhe PIRLS (2021). Rezultatet e nxënësve kosovarë në vlerësimet ndërkombëtare janë kritike, ndër më të ulëtat nga vendet pjesëmarrëse. Ky studim rasti, cilësor, ka për objekt trajtimi tri çështje kryesore: (i) shqyrton rregullimet dhe udhëzimet për përdorimin e rezultateve të vlerësimit për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënies e nxënësve në politikat arsimore, dokumentet kurrikulare, programet e trajnimit, udhëzuesit për mësimdhënës; (ii) shqyrton shkallën e përfshirjes së përdorimit të rezultateve të vlerësimeve të nxënësve për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të nxënies në planet zhvillimore të shkollës dhe planet e aktiveve profesionale (në fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi, Matematika dhe Shkencat), si dhe (iii) përshkruan

Abstract

Student assessment and the use of assessment results for the purposes of improving teaching and learning is a topic of particular importance for researchers in Kosovo. Kosovo has been organizing regular national assessments in pre-university education for several years, in addition to the internal student assessment at the school level. Additionally, from 2015, Kosovo participates in international assessments, such as PISA (2015, 2018 and 2022), TIMSS (2019) and PIRLS (2021). The results of Kosovar students in international assessments are critical, among the lowest among the participating countries. This qualitative case study addresses three main issues: (i) examines regulations and guidelines for using assessment results to improve teaching and student learning in educational policies, curriculum documents, training programmes, and teacher guidelines; (ii) explores the degree of inclusion of the use of student assessment results for the improvement of teaching and learning practices in school development plans and professional activity plans (in the curricular areas of Languages and Communication, Mathematics and Sciences), as well as (iii) describes the compatibility of the views

¹⁹ MA Selim Mehmeti është hulumtues në IPK, selimmehmeti.ipk@gmail.com
MA Selim Mehmeti is a researcher at KPI, selimmehmeti.ipk@gmail.com

përputhshmërinë e pikëpamjeve të 7 drejtorëve të shkollave dhe 14 udhëheqësve të aktiveve profesionale për përdorimin e rezultateve të vlerësimeve të nxënësve, në raport me rolin dhe përgjegjësitë e tyre për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të nxënësve. Studimi synon të kontribuojë në ngritjen e kulturës për përdorimin e rezultateve të vlerësimeve të nxënësve për qëllime të përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënies dhe jo vetëm.

Fjalët kyçe: vlerësimi i nxënësve, arritjet e nxënësve, përdorimi i të dhënave, vendimmarrja e bazuar në të dhëna, përmirësimi i vazhdueshëm.

of 7 school principals and 14 professional activity leaders on the use of student assessment results, in relation to their role and responsibilities for improving teaching and learning practices. The study aims to contribute to raising the culture of using the results of student assessments for the purposes of improving teaching and learning and not only.

Keywords: student assessment, student achievement, data usage, data-based decision making, continuous improvement

TEMA 2. KOSOVA NË VLERËSIMET NDËRKOMBËTAR
TOPIC 2. KOSOVO IN INTERNATIONAL ASSESSMENTS

HULUMTIMI I NDËRTHURJES SË FAKTORËVE EKONOMIKË, SOCIALË, MJEDISORË DHE POLITIKË NË REZULTATET E PISA-s

EXAMINING THE INTERSECTION OF ECONOMIC, SOCIAL, ENVIRONMENTAL AND POLITICAL FACTORS IN PISA OUTCOMES

Besart Hyseni²⁰

Abstrakt

Qëllimi i këtij studimi është të hulumtohet marrëdhënia e ndërlidhur mes çështjeve politike, sociale, ekonomike dhe mjedisore dhe rezultatet e Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve (PISA). Pasi që PISA është një instrument vlerësimi i njohur ndërkombëtarisht që e vlerëson performancën akademike të nxënësve 15-vjeçar përtej kufijve shtetërorë, do të bëhet një hulumtim i ndërthurjes së këtyre faktorëve për të ofruar të dhëna rreth çështjeve të ndërlidhura që ndikojnë në rezultatet arsimore anembanë botës. Për këtë qasje është përdorur baza e të dhënave të PISA-s për analizimin e të dhënave dhe softuerët Anaconda-Jupyter Notebook-Python dhe SPSS janë përdorur për trajtimin e të dhënave. Për t'i gjetur korrelacionet, regresionet dhe modelet ndërmjet treguesve ekonomikë, strukturave sociale, rrethanave mjedisore, sistemeve politike dhe performancës së nxënësve, do të mblidhen të dhënat nga cikli i fundit i PISA-s dhe do të përpunohen përmes një analize të thukët statistikore. Studimi ka peshë shkencore pasi që mund ta vërë në pah ndërvarësinë e shumë përbërësve socio-ekonomikë dhe ndikimin e tyre

Abstract

The aim of this study is to examine the complex relationship between political, social, economic, and environmental issues and the results of the Programme for International Student Assessment (PISA). Given that PISA is an internationally recognized assessment instrument that assesses 15-year-old students' academic performance across national boundaries, an investigation into the intersectionality of these factors will be carried out to offer insights into the complexity influencing educational outcomes worldwide. The approach uses the PISA database for data analysis and Anaconda-Jupyter Notebook-Python and SPSS software are used to handle the data. In order to find correlations, regressions, and patterns between economic indicators, social structures, environmental circumstances, political systems, and student performance, data from the most recent PISA cycle will be gathered and put through a thorough statistical analysis. The research holds scholarly significance as it might reveal the interdependence of many socioeconomic components and their influence on academic

²⁰ Prof.Dr.Sci. Besart Hyseni, Universiteti i Evropës Juglindore, Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore
besart.s.hyseni@gmail.com
Prof.Dr.Sci. Besart Hyseni, South East European University, Faculty of Contemporary Sciences and Technologies
besart.s.hyseni@gmail.com

në performancën akademike. Politikëbërësit, mësimdhënësit dhe aktorët e tjerë mund të krijojnë politika që i lehtësojnë pabarazitë dhe i përmirësojnë rezultatet arsimore në nivel global, duke i marrë parasysh këto ndërlidhje. Studimi po ashtu ofron informata të rëndësishme për politikën dhe praktikën arsimore dhe i avancojnë njohuritë tona rreth faktorëve kompleks, që ndikojnë në rezultatet e PISA-s.

Fjalët kyçe: rezultatet e PISA-s, faktorët ekonomikë, ndikimet sociale, ndikimi mjedisor, dinamikat politike, politika arsimore, vlerësimi global, hulumtimi ndërdisiplinor.

performance. Policymakers, educators, and other stakeholders may create policies to alleviate inequities and enhance educational results globally by taking into account these linkages. The study also provides insightful information for educational policy and practice and advances our knowledge of the complex factors that affect PISA results.

Keywords: PISA outcomes, Economic factors, Social influences, Environmental impact, Political dynamics, Education policy, Global assessment, Interdisciplinary research.

**INTEGRIMI I DIMENSIONEVE
NEUROKOGNITIVE NË VLERËSIMET
ARSIMORE: STRATEGJITË PËR NGRITJEN
E CILËSISË NË VLERËSIMIN KOMBËTAR
DHE NDËRKOMBËTAR NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË**

**INTEGRATING NEUROCOGNITIVE
DIMENSIONS IN EDUCATIONAL
ASSESSMENTS: STRATEGIES FOR
QUALITY IMPROVEMENT IN NATIONAL AND
INTERNATIONAL ASSESSMENT IN PRE-
UNIVERSITY EDUCATION IN KOSOVO**

Amantina Pervizaj Kelmendi²¹

Abstrakt

Ky hulumtim i eksploron dimensionet neurokognitive të vlerësimeve arsimore në rrethet parauniversitare në Kosovë, me një fokus të veçantë në përmirësimin e performancës në teste ndërkombëtare, si PISA dhe TIMSS. Në përputhje me temën e konferencës, studimi ynë sjell njohuri të rëndësishme për avancimin e arritjeve arsimore të Kosovës në skenën ndërkombëtare. Për më tepër, hulumtimi avokon për integrimin strategjik të qasjeve neurokognitive të kontekstualizuara, duke theksuar rolin e ndryshueshëm të sinjaleve kontekstuale në riformatimin e metodologjive të vlerësimit për standarde globale. Studimi propozon strategji praktike për integrimin e këtyre qasjeve në materiale mësimore për të ngritur pozicionin e Kosovës në vlerësime arsimore ndërkombëtare. Gjithashtu, hulumtimi nënvizon adaptueshmërinë neurokognitive të nxënësve dhe suksesin e metodave të personalizuar të mësimin. Ai thekson rolin e tyre kryesor në formimin e së ardhmes së praktikave arsimore dhe në shtyrjen e studentëve kosovarë drejt njohurive ndërkombëtare. Duke përdorur një trekëndëzim të metodave të ndikuara nga Jessner dhe Kramsch (2009), studimi ynë

Abstract

This research explores the neurocognitive dimensions of educational assessments in pre-university districts in Kosovo, with a particular focus on improving performance in international tests, such as PISA and TIMSS. In accordance with the theme of the conference, our study brings important insights for the advancement of Kosovo's educational achievements on the international stage. Additionally, the research advocates for the strategic integration of contextualized neurocognitive approaches, emphasizing the changing role of contextual cues in reformatting assessment methodologies for global standards. The study proposes practical strategies for integrating these approaches into teaching materials to raise Kosovo's position in international educational assessments. Additionally, research highlights the neurocognitive adaptability of students and the success of personalized learning methods. It stresses their main role in shaping the future of educational practices and in pushing Kosovar students towards international knowledge. Using a triangulation of

²¹ Dr. Sc. Amantina Pervizaj Kelmendi, Neuroshkencë kognitive dhe gjuhësi amantinapk@gmail.com
Dr. Sc. Amantina Pervizaj Kelmendi, Cognitive neuroscience and linguistics amantinapk@gmail.com

përdor një test aftësie (të gjuhës së dytë), një pyetësor të standardizuar (SILL/Oxford 1999), një anketë/intervistë me mësimdhënës rreth metodave të mësimdhënies dhe së fundmi për matjen neurokognitive një detyrë kognitive (kompjuterike) dhe një ndjekës sysh (eye tracker). Gjetjet parashikojnë zbulimin e dallimeve në perspektivat e pedagogëve dhe të nxënësve në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve, duke dhënë njohuri të rëndësishme, të bazuara në parimet neurokognitive dhe duke propozuar strategji të veprueshme për përmirësimin e mjediseve të mësimin.

Fjalët kyçe: dimensione neurokognitive, vlerësime arsimore, arsim parauniversitar, qasje kontekstuale, strategji mësimore të personalizuar, mësim gjuhe, ndjekja me sy.

methods influenced by Jessner and Kramersch (2009), our study uses a (second language) proficiency test, a standardized questionnaire (SILL/Oxford 1999), a teacher survey/interview about teaching methods and, finally, for neurocognitive measurement a cognitive (computer) task and an eye tracker. The findings anticipate the discovery of differences in the perspectives of educators and students in the teaching and learning process, providing important insights based on neurocognitive principles and proposing actionable strategies for improving learning environments.

Keywords: neurocognitive dimensions, educational assessments, pre-university education, contextual approach, personalized learning strategies, language learning, eye tracker.

CILËSIA E PËRKTHIMIT NË GJUHËN SHQIPE TË INSTRUMENTEVE TË VLERËSIMIT TË PISA-S DHE TIMSS-it

THE QUALITY OF THE TRANSLATION INTO ALBANIAN OF THE PISA AND TIMSS ASSESSMENT INSTRUMENTS

Luella Liçi²²

Abstrakt

Përkthimi i instrumenteve ndërkombëtare të vlerësimit të PISA-s dhe TIMSS-it në gjuhën shqipe ka filluar që në vitin 1999 dhe ka vazhduar për 25 vjet, por hulumtimi i parë për cilësinë e përkthimit të tyre është kryer në vitin 2022. Ky referim përmban një përmbledhje të gjetjeve, përfundimeve dhe rekomandimeve për cilësinë e përkthimit të instrumenteve të vlerësimit të PISA-s 2018 dhe të TIMSS-it 2019, që janë përdorur në Shqipëri, në Kosovë dhe në Malin e Zi. Kërkimi u krye me metodologjinë empirike dhe metodat e kërkimit cilësor. U përdor modeli krahasues, shkakësor dhe i procesit; të dhënat e ndërhyrjeve të verifikuesit ndërkombëtar, të paraqitura në CAS 2018 dhe matrica e gabimeve, e krijuar për këtë kërkim. U analizuan 53 shembuj nga testet, pyetësorët dhe dy udhëzues të kodimit. Kërkimi gjeti se cilësia e përkthimit është cenuar nga probleme të barasvlerës së përkthimit, që lidhen me: 1) gabimet e përkthimit; 2) dallimet gjuhësore; 3) përkthyesin; 4) procedurën e përkthimit dhe të redaktimit. Kërkimi zbuloi se barasvlera kuptimore është cenuar më shumë sesa barasvlera gjuhësore dhe kulturore dhe se barasvlera e përkthimit është cenuar më shumë në testet sesa në pyetësorët dhe udhëzuesit e kodimit. Kërkimi përcaktoi katër faktorë të problemeve të cilësisë së

Abstract

The translation of the international assessment instruments of PISA and TIMSS into the Albanian language began in 1999 and continued for 25 years, but the first research on the quality of their translation was carried out only in 2022. This reference contains a summary of findings, conclusions and recommendations for the quality of the translation of the PISA 2018 and TIMSS 2019 assessment instruments that have been used in Albania, Kosovo and Montenegro. The research was conducted with empirical methodology and qualitative research methods. The comparative, causal and process model was used; the international verifier intervention data presented at CAS 2018 and the error matrix created for this research. 53 examples from tests, questionnaires and two coding guides were analysed. The research found that translation quality is compromised by translation equivalence problems related to: 1) translation errors; 2) language differences; 3) the translator; 4) translation and editing procedure. The research found that semantic equivalence is violated more than linguistic and cultural equivalence and that translation equivalence is violated more in tests than in questionnaires and coding guides. The research determined four factors of the quality

²² Dr. Luella Liçi, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, luella_lichi@yahoo.com
Dr. Luella Liçi, Faculty of Foreign Languages, University of Tirana, luella_lichi@yahoo.com

përkthimit të instrumenteve ndërkombëtare të vlerësimit në gjuhën shqipe: a) cilësia e diskutueshme e ekipit të përkthyesve; b) përzgjedhja e modelit të përkthimit; c) realizimi i një procesi të paefektshëm përkthimi dhe redaktimi; d) mungesa e bashkërendimit të ekipeve të përkthyesve të katër vendeve, që përdorin instrumentet e vlerësimit të PISA-s dhe të TIMSS-it në gjuhën shqipe. Kërkimi arriti në përfundimin se cilësia e përkthimit do të sigurohet nëpërmjet: a) një ekipi cilësor të përkthyesve profesionistë; b) përdorimit të modelit të përkthimit të bazuar në dy burime paralele ndërkombëtare ose me përkthim të dyfishtë të një burimi, por me kontroll të kryqëzuar; c) redaktimit të efektshëm; d) bashkërendimit të veprimtarisë së ekipeve të përkthyesve të katër vendeve, që përdorin instrumentet e vlerësimit të PISA-s dhe TIMSS-it në gjuhën shqipe, që prodhon versione kohezive, por që pasqyrojnë specifikat e përdorimit lokal.

Fjalët kyçe: cilësi e përkthimit, problem i përkthimit, verifikim i cilësisë së përkthimit, instrument i vlerësimit.

problems of the translation of the international assessment instruments in the Albanian language: a) the questionable quality of the team of translators; b) selection of the translation model; c) performing an ineffective translation and editing process; d) lack of coordination of the teams of translators of the four countries, who use the PISA and TIMSS assessment instruments in the Albanian language. The research concluded that translation quality will be ensured through: a) a quality team of professional translators; b) using the translation model based on two parallel international sources or with double translation of one source, but with cross-checking; c) effective editing; d) coordinating the activity of teams of translators from four countries, who use the assessment instruments of PISA and TIMSS in the Albanian language, which produces cohesive versions, but which reflect the specifics of local use.

Keywords: quality of translation, translation issue, translation quality assurance, assessment instrument.

NDIKIMI I FAKTORËVE SOCIO- EKONOMIKË DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE NË FËMIJËRINË E HERSHME NË ARRITJET AKADEMIKE TË FËMIJËVE NË TIMSS 2019

THE IMPACT OF SOCIOECONOMIC FACTORS AND EARLY CHILDHOOD EDUCATION ON CHILDREN'S ACADEMIC ACHIEVEMENT IN TIMSS 2019

Fadil Latifi²³

Abstrakt

Edukimi dhe kujdesi për fëmijët në moshë të re është një faktor përcaktues në arritjet e tyre të mëvonshme akademike. Periudha (*koha kalendarike*) që kalojnë fëmijët në institucionet parashkollore eliminon hendekun dhe disavantazhet që mund të krijohen me kalimin e viteve. Sa më e gjatë kjo periudhë, aq më të larta janë arritjet akademike të fëmijëve. Fokusi i këtij studimi është të argumentojë rëndësinë e edukimit dhe të kujdesit për fëmijët e vegjël në aspektin formal (*shkollor*) dhe informal (*familjar*), duke përfshirë aspektin socio-ekonomik në arritjet e mëvonshme akademike të fëmijëve. Punimi analizon dhe krahason të dhënat nga anketa me prindërit e fëmijëve që i janë nënshtruar testit TIMSS 2019 (*Trends in International Mathematics and Science Study*), me rezultatet e arritura nga nxënësit e klasës së katërt në test. Për qëllime kërkimore, nga baza e të dhënave TIMSS 2019, janë marrë vetëm të dhënat nga testimi i studentëve kosovarë. Mostra përfshin 4435 nxënës dhe prindërit/kujdestarët e tyre. Të dhënat tregojnë se periudha e kaluar nga fëmijët e moshës 0-6 vjeç në institucionet parashkollore, si dhe

Abstract

The education and care of children at a young age is a determining factor in their subsequent academic achievements of children. The period (*calendar time*) that children spend in preschool institutions, eliminates the gap and disadvantages that can be created over the years. The longer this period, the higher the academic achievement of the children. The focus of this study is to argue the importance of education and care for young children in a formal (*school*) and informal (*family*) aspect, including the socioeconomic aspect in the children's later academic achievements. The paper analyzes and compares the data from the survey with parents of children who have undergone the TIMSS 2019 test (*Trends in International Mathematics and Science Study*), with the results achieved by fourth-grade students in the test. For research purposes, from the TIMSS 2019 database, only data from the testing of Kosovar students were taken. The sample work includes 4435 students and their parents/guardians. The data show that the period spent by children aged 0-6 years in preschool institutions, as well as the variety of constructive activities that parents carry

²³ Prof. ass. dr. Fadil Latif është profesor në AAB fadil.latifi.phd@gmail.com
Prof. ass. dr. Fadil Latif is a professor at AAB fadil.latifi.phd@gmail.com

shumëllojshmëria e aktiviteteve konstruktive që prindërit kryejnë me fëmijët e tyre në familje, duke përfshirë kushtet socio-ekonomike në familje, përkthehet më vonë në arritjet akademike.

Fjalët kyçe: arsimi i hershëm, Kosovë, vlerësimi TIMSS, arritje akademike, institucionet parashkollore.

out with their children in the family, including the socio-economic conditions in the family, translates into later academic achievements.

Keywords: Early education, Kosovo, TIMSS assessment, academic achievement, preschool institutions.

SHQYRTIMI I MARRËDHËNIEVE NË MES TË ANGAZHIMIT TË BRENDSHËM AKADEMIK, KURIOZITETIT, ANKTHIT NDAJ MATEMATIKËS DHE SUKSESIT NË TESTIN PISA

EXPLORING THE RELATIONSHIPS BETWEEN INTERNAL ACADEMIC ENGAGEMENT, CURIOSITY, MATH ANXIETY, AND SUCCESS IN THE PISA TEST

Lekë Ukaj²⁴, Fatmir Mehmeti²⁵ & Artan Reshani²⁶

Abstrakt

Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë ndërlidhjen në mes të angazhimit të brendshëm akademik, kuriozitetit, ankthit ndaj matematikës, dhe suksesit në testin PISA. Numri reprezentativ përbëhet nga gjithsej 6,027 nxënës (3,928 vajza dhe 3,099 djem), nga 229 shkolla, përfaqësues të 21,000 nxënësve 15-vjeçar në Kosovë. Këta nxënës përfshinin nxënësit e klasave të 8-ta deri te klasat e 12-ta. Të dhënat janë marrë nga databaza e testit PISA 2022. Variablat e pavarura në këtë studim përfshijnë angazhimin e brendshëm akademik, kuriozitetin dhe ankthin ndaj matematikës, ndërsa variabli i varur është sukcesi në testin PISA. Për analizën e të dhënave është përdorur programi The International Association for the Evaluation of Educational Achievement (IEA) International Database (IDB) Analyser. Analiza e regresionit është bërë për të ekzaminuar ndërlidhjen në mes të angazhimit të brendshëm akademik, kuriozitetit, ankthit ndaj matematikës, dhe suksesit në testin PISA. Rezultatet tregojnë se

Abstract

The purpose of this study is to explore the relationship between internal academic engagement, curiosity, math anxiety, and success in the PISA test. The representative sample consists of a total of 6,027 students (3,928 girls and 3,099 boys), from 229 schools, representing 21,000 15-year-old students in Kosovo. These students included students in grades 8 through 12. The data is taken from the PISA 2022 test database. The independent variables in this study include intrinsic academic engagement, curiosity and anxiety towards mathematics, while the dependent variable is success in the PISA test. The International Association for the Evaluation of Educational Achievement (IEA) International Database (IDB) Analyser programme was used for data analysis. Regression analysis was done to examine the relationship between internal academic engagement, curiosity, math anxiety, and success in the PISA test. The results show that

²⁴ Msc. Lekë Ukaj, mësimdhënës në ShFMU “Besim Nrecaj” ukajleka1@gmail.com

Msc. Lekë Ukaj, teacher at ELSS “Besim Nrecaj” ukajleka1@gmail.com

²⁵ Prof. asoc. dr. Fatmir Mehmeti, Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, Fakulteti i Edukimit fatmir.mehmeti@uni-prizren.com

Prof. Ass. Dr. Fatmir Mehmeti, “Ukshin Hoti” University in Prizren, Faculty of Education fatmir.mehmeti@uni-prizren.com

²⁶ Por. ass. dr. Artan Reshani, Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, Fakulteti i Edukimit artan.reshani@uni-prizren.com

Prof. Ass. Dr. Artan Reshani, “Ukshin Hoti” University in Prizren, Faculty of Education artan.reshani@uni-prizren.com

angazhimi i brendshëm akademik dhe kurioziteti kanë ndikim pozitiv në uljen e nivelit të ankthit ndaj matematikës dhe rritjen e suksesit në matematikë. Gjetjet sugjerojnë që mësuesit dhe politikëbërësit duhet të marrin parasysh kuriozitetin dhe angazhimin e brendshëm akademik të nxënësve, pasi këto variabla luajnë një rol të rëndësishëm në uljen e ankthit ndaj matematikës dhe përmirësimin e arritjeve në matematikë të nxënësit në Kosovë.

Fjalët kyçe: angazhimi i brendshëm akademik, ankthi ndaj matematikës, kurioziteti, sukcesi në testin PISA.

internal academic engagement and curiosity have a positive impact on reducing the level of anxiety towards mathematics and increasing success in mathematics. The findings suggest that teachers and policy makers should consider students' internal academic curiosity and engagement, as these variables play an important role in reducing math anxiety and improving math achievement among students in Kosovo.

Keywords: internal academic engagement, math anxiety, curiosity, success in the PISA test.

**TEMA 3. KRAHASIMI I VLERËSIMEVE KOMBËTARE
ME PËRVOJA NGA VENDET E TJERA**

**TOPIC 3. COMPARING NATIONAL ASSESSMENTS
AND EXPERIENCES FROM DIFFERENT COUNTRIES**

ROLI I VLERËSIMIT FORMATIV NË PËRMIRËSIMIN E REZULTATEVE TË VLERËSIMIT KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

THE ROLE OF FORMATIVE ASSESSMENT IN THE IMPROVEMENT OF NATIONAL AND INTERNATIONAL ASSESSMENT RESULTS

Bardha Gashi²⁷

Abstrakt

Punimi eksploron rolin e sintezës strategjike në përafrimin e praktikave të vlerësimit formativ me gjetjet kombëtare dhe ndërkombëtare të vlerësimit. Ndërsa sistemet arsimore në mbarë botën mbështeten gjithnjë e më shumë në metodologji të ndryshme vlerësimi për të vlerësuar të nxënit e nxënësve, nevoja për integrim koherent të praktikave të vlerësimit formativ është bërë parësore. Andaj, ky punim thellohet në rëndësinë e sintetizimit të qasjeve të vlerësimit formues me korniza më të gjera të vlerësimit për të rritur dobinë dhe ndikimin e vlerësimeve arsimore. Nëpërmjet një shqyrtimi të strategjive efektive, punimi në fjalë nënvizon rëndësinë e shtrirjes strategjike në nxitjen e njohurive arsimore gjithëpërfshirëse dhe depërtuese që nxisin përmirësimin e vazhdueshëm. Gjatë dy dekadave të fundit, Kosova ka kaluar nëpër disa pilot projekte sa i përket kurrikulave në arsimin para universitar. Në përgjithësi, këto kurrikula provuese kanë pasur ndikime në aspektet zhvillimore, por në anën tjetër edhe kanë hasur në ngecje. Hulumtimi është fokusuar në efikasitetin e aplikimit të vlerësimit formativ në shkollat e mesme të larta, si dhe përshtatja e instrumenteve të vlerësimit me ato ndërkombëtare. Sinteza strategjike nga pyetësorët

Abstract

The paper explores the role of strategic synthesis in aligning formative assessment practices with national and international assessment findings. As education systems around the world increasingly rely on different assessment methodologies to assess student learning, the need for coherent integration of formative assessment practices has become paramount. Therefore, this paper delves into the importance of synthesizing formative assessment approaches with broader assessment frameworks to increase the utility and impact of educational assessments. Through an examination of effective strategies, this paper highlights the importance of strategic alignment in fostering comprehensive and insightful educational knowledge that fosters continuous improvement. During the last two decades, Kosovo has gone through several pilot projects in terms of curricula in pre-university education. In general, these trial curricula have had impacts on developmental aspects, but on the other hand, they have also encountered setbacks. The research is focused on the efficiency of the application of formative assessment in upper secondary schools, as well as the adaptation of assessment instruments to international ones. Strategic synthesis from

²⁷ PhD Bardha Gashi është ligjëruese në UP bardhag2@gmail.com
PhD Bardha Gashi is a lecturer at UP bardhag2@gmail.com

e një mostre prej 300 mësimehënësve, të cilët ligjërojnë në shkollat e mesme të larta, ka treguar se nga një varietet i gjerë lëndësh, duke përfshirë matematikën, shkencat, gjuhët dhe artet, shumica e mësimehënësve përdorin teknika të vlerësimit formativ çdo javë, me një përqindje të konsiderueshme që i përdorin çdo ditë. Megjithatë, ka edhe një grup mësimehënësish që i përdorin këto teknika rrallë, duke treguar variacion në zbatimin e vlerësimit formativ, sidomos gjatë procesit mësues. Sa u përket sfidave që hasin mësimehënësit në aplikimin e vlerësimit formativ, që po ashtu është i obligueshëm dhe duhet të përshtatet me kompetencat e kurrikulës bazë për shkollat të mesme të larta dhe me kërkesat për zhvillimin e shkathtësive të shekullit XXI, 60% e mësimehënësve përmendin mungesën e trajnimit si sfidë kryesore, 50% mungesën e kohës dhe bashkëpunimit, dhe 40% mungesën e burimeve, ndërsa 25% hasin në rezistencë nga nxënësit. Gjithashtu, nga pyetjet në lidhje me zbatueshmërinë e instrumenteve të vlerësimit dhe përputhjen e tyre me notën përfundimtare, tregohet se ka mospërputhje në mes të vlerësimit formues dhe përmbledhës. Si përfundim, duke ndjekur rekomandimet që rrjedhin nga ky hulumtim, palët e interesuara në arsim mund të nxisin sintezën strategjike dhe përafrimin e praktikave të vlerësimit dhe përmbajtjeve mësuese, duke çuar përfundimisht në përmirësimin e rezultateve arsimore dhe suksesin e nxënësve në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fjalët kyçe: vlerësimi formativ, arsimi parauniversitar, vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare, strategjitë.

questionnaires of a sample of 300 teachers who teach in upper secondary schools has shown that across a wide variety of subjects, including mathematics, sciences, languages and arts, most teachers use formative assessment techniques every week, with a significant percentage using them daily. However, there is also a group of teachers who rarely use these techniques, showing variation in the implementation of formative assessment, especially during the teaching process. Regarding the challenges faced by teachers in the application of formative assessment, which is also mandatory and must be adapted to the competencies of the basic curriculum for upper secondary schools and the requirements for the development of 21st century skills, 60% of teachers mention lack of training as the main challenge, 50% lack of time and cooperation, and 40% lack of resources, while 25% encounter resistance from students. Further, the questions regarding the applicability of the assessment instruments and their compliance with the final grade show that there is a discrepancy between the formative and summative assessment. In conclusion, by following the recommendations derived from this research, stakeholders in education can promote strategic synthesis and alignment of assessment practices and instructional content, ultimately leading to improved educational outcomes and student success in national and international assessments.

Keywords: formative assessment, pre-university education, national and international assessments, strategies.

NDIKIMI I KURRIKULËS NË ARRITJET E NXËNËSVE NË TESTIMET KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

THE IMPACT OF THE CURRICULUM ON STUDENTS' ACHIEVEMENT IN NATIONAL AND INTERNATIONAL TESTS

Belgizare Kryeziu²⁸ & Ismet Potera²⁹

Abstrakt

Në ditët e sotme, me zhvillimet e shpejta, reforma në arsim dhe inovacioni i kurrikulës janë bërë prirje e re në zhvillimin e arsimit. Në të njëjtën kohë, në reformën arsimore, arsimimi bazë është fokusi dhe çelësi i formimit të nxënësve. Midis shumë cilësive dhe kompetencave, aftësia e të nxënësve është veçanërisht e rëndësishme për të dëshmuar rezultate të kënaqshme në testimet ndërkombëtare. Për nxënësit e shkollave të arsimit bazë, zhvillimi i shkathtësive të tyre mësimore kryhet kryesisht përmes shkollave dhe procesit të mësimdhënies nga mësimdhënësit, prandaj edukimi shkollor dhe mënyra e mësimit të kurrikulës luan një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e shkathtësive mësimore të nxënësve. Është shumë e rëndësishme të identifikohet ndikimi i inovacionit të kurrikulës në shkathtësitë e të nxënësve.

Në këtë punim, marrëdhënia dhe ndikimi mes të dyjave, inovacionit të kurrikulës dhe shkathtësitë e të nxënësve, analizohet dhe studiohet me anë të pyetësorëve dhe analizave empirike, edhe atë duke përdorur pyetësorin standard për kurrikulën bazuar në kompetenca, të IPK-së (Institutit Pedagogjik të Kosovës, 2019), me të

Abstract

Nowadays, with rapid developments, education reform and curriculum innovation have become a new trend in education development. At the same time, in the educational reform, basic education is the focus and key to student development. Among many qualities and competences, students' learning ability is particularly important to demonstrate satisfactory results in international tests. For students of basic education schools, the development of their learning skills is mainly carried out through schools and the teaching process by teachers, therefore school education and the method of teaching the curriculum plays a very important role in the development of students' learning skills. It is very important to identify the impact of curriculum innovation on students' learning skills.

This paper explores and studies the relationship and impact between the two, curriculum innovation and students' learning skills through questionnaires and empirical analysis, also using the standard questionnaire for the competence-based curriculum of the KPI (Kosovo Pedagogical Institute, 2019), which was used to survey around 250 teachers, then official data or international

²⁸ MA Belgizare Kryeziu është drejtoreshë shkolle dhe PhD candidate
MA Belgizare Kryeziu is a school principal and PhD candidate

²⁹ Dr. sci. Ismet Potera është hulumtues në IPK
Dr. sci. Ismet Potera is a researcher at KPI

cilën anketohen rreth 250 mësimdhënës, më pas të dhënat zyrtare apo rezultatet ndërkombëtare nga raporti vjetor Pisa, si pasqyrë: Sfidat e arsimit në Kosovë (2024), ku janë testuar 6027 nxënës në matematikë, lexim dhe shkencë, në vitin 2022, si dhe rezultatet kombëtare të suksesit të nxënësve në raportin e auditimit të performancës, publikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA). Me anë të statistikave komparative deskriptive (mesataret dhe devijimet standarde) dhe konkluzive (koeficientet korelative dhe analizës regresive) nxirren konkludime rreth ndërlidhjes së kualitetit të arsimit (kurrikulës bazuar në kompetencave) dhe suksesit të nxënësve në segmentin kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe konkludime faktoriale për rezultatet e ulëta të nxënësve në këto teste. Pra, hulumtimi i këtij punimi përbëhet nga pjesët në vijim: sfondi, rëndësia dhe kontributi i hulumtimit, konceptet dhe literatura e përfshirë në hulumtim, metodologjia e hulumtimit, përgatitja e pyetësorit, analiza e të dhënave. Punimi përmbledh problemet e shkathtësive të të nxënësve dhe inovacionit të kurrikulës dhe propozon zgjidhje të synuara nga këndvështrimi i inovacionit të kurrikulës për të pasur rezultate të kënaqshme në arritjet e nxënësve, testimet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fjalët kyçe: inovacioni i kurrikulës, kompetencat e të nxënësve, arritjet e nxënësve, ndikimi.

results from the annual Pisa report, as an overview: Challenges of education in Kosovo (2024), where 6027 students were tested in mathematics, reading and science, in 2022, as well as national student success results in the performance audit report published by the National Audit Office (NAO). By means of comparative descriptive (means and standard deviations) and inferential (correlation coefficients and regression analysis) statistics, conclusions are drawn about the relationship between the quality of education (competence-based curriculum) and the student success in the national and international segment, as well as factorial conclusions for the low results of students in these tests. Thus, the research of this paper consists of the following parts: background, rationale and contribution of the research, concepts and literature included in the research, research methodology, questionnaire preparation, data analysis. The paper summarizes the problems of students' learning skills and curriculum innovation and proposes targeted solutions from the perspective of curriculum innovation to have satisfactory results in student achievement, national and international testing.

Keywords: curriculum innovation, learning competencies, student achievement, impact.

ROLI I ARSIMIT PARASHKOLLOR NË PERFORMANCËN E NXËNËSVE NË KOSOVË NË TESTIN PISA: NJË ANALIZË KRAHASUESE ME VENDET E RAJONIT

THE ROLE OF PRE-SCHOOL EDUCATION IN KOSOVO STUDENTS' PERFORMANCE IN THE PISA TEST: A COMPARATIVE ANALYSIS WITH REGIONAL COUNTRIES

Kujtime Kryeziu³⁰

Abstrakt

Fëmijëria e hershme është një periudhë e rëndësishme për zhvillimin e aftësive të përgjithshme të fëmijëve. Në zhvillimin dhe promovimin e të nxënësve të fëmijëve në këtë periudhë, arsimit parashkollor ka një rol të rëndësishëm. Ky studim synoi të eksplorojë efektivitetin e arsimit parashkollor, duke analizuar marrëdhënien midis frekuentimit të arsimit parashkollor dhe aftësive akademike të mëvonshme, duke përdorur të dhënat nga PISA. Rezultatet e PISA-s tregojnë se në të gjitha vendet e OECD-së studentët që kishin ndjekur arsimin parashkollor priren të kenë rezultate më të larta në aftësitë akademike në moshën 15-vjeçare. Megjithatë, dallimet në aftësitë akademike janë jo shumë të dukshme, pothuajse fare, midis atyre fëmijëve që morën pjesë në arsim parashkollor kundrejt atyre që nuk morën pjesë në arsim parashkollor, kur merret parasysh statusi socio-ekonomik i fëmijëve. Për më tepër, rezultatet tregojnë se hyrja në programet e arsimit parashkollor më herët se koha e zakonshme shoqërohet me aftësi më të ulëta në moshën 15-vjeçare. Pra, përfitimet e të mësuarit nga arsimi parashkollor ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në vendet e PISA-s, që janë me

Abstract

Early childhood is an important period for the development of children's general skills. In the development and promotion of children's learning in this period, preschool education has an important role. This study aimed to explore the effectiveness of preschool education by analysing the relationship between preschool education attendance and later academic performance, using data from PISA. PISA results show that in all OECD countries, students who attended pre-school education tend to score higher in academic skills at age 15. However, differences in academic ability are not very evident, almost at all, between those children who attended preschool education versus those who did not attend preschool education, when children's socioeconomic status is taken into account. Furthermore, the results show that entering preschool education programmes earlier than the usual time is associated with lower skills at age 15. Thus, learning gains from pre-school education vary considerably across PISA countries, which are of higher quality compared to Kosovo and neighbouring countries, highlighting the importance of a quality policy context. Analyses of

³⁰ MA .Sc. Kujtime Kryeziu është mësuesimdhënëse kujtimekryeziu@gmail.com
MA. Sc. Kujtime Kryeziu, teacher and researcher kujtimekryeziu@gmail.com

cilësi më të lartë krahasuar me Kosovën dhe vendet e përrefërta me të, duke u vënë në pah rëndësia e një konteksti politikash cilësore. Analizat e disa faktorëve të cilësisë vënë në dukje se përmirësimi i cilësisë së arsimit parashkollor shoqërohet me aftësi më të larta akademike të fëmijët në fazat e mëvonshme. Këto rezultate theksojnë se ndjekja e thjeshtë e arsimit parashkollor nuk është e mjaftueshme për të siguruar performancë më të mirë akademike. Duhet të sigurohet cilësia e arsimit parashkollor, veçanërisht për ata fëmijë me prejardhje të pafavorshme socio-ekonomike.

Fjalët kyçe: ndjekja e arsimit parashkollor, statusi socio-ekonomik, rezultatet në PISA, politikat arsimore, aftësitë akademike.

several quality factors point out that improving the quality of preschool education is associated with higher academic skills in children at later stages. These results emphasize that simply attending pre-school education is not enough to ensure better academic performance. The quality of pre-school education must be ensured, especially for those children from disadvantaged socio-economic backgrounds.

Keywords: preschool attendance, socio-economic status, PISA results, educational policies, academic skills

ANALIZË KRAHASUESE E TESTEVE KOMBËTARE DHE TESTIT PISA NË KOSOVË

A COMPARATIVE ANALYSIS OF NATIONAL AND PISA TESTING IN KOSOVO

Sevdije Berisha Krasniqi³¹

Abstrakt

Vlerësimi është procesi gjatë të cilit mbledhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së rezultateve të të nxënës, duke u bazuar në nivelet e arritjes. Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar në Kosovë përcakton dy lloje të vlerësimit: vlerësimin e brendshëm dhe vlerësimin e jashtëm shtetëror. Që nga viti 2015, Kosova i është nënshtruar edhe vlerësimit ndërkombëtar PISA. Qëllimi i studimit është të analizojë ngritjen dhe rënien e arsimit në Kosovë, duke u bazuar në rezultatet e testeve kombëtare dhe të PISA-s. Duke krahasuar dhe vlerësuar rezultatet e testeve kombëtare dhe testit PISA, si dhe përmes metodës analitike, do të nxjerrim në pah situatën në të cilën ndodhet sistemi arsimor në Kosovë, përkatësisht do të identifikojmë faktorët dhe shkaqet që ndikojnë në ngritjen apo rënien e cilësisë së arsimit në vend, si dhe do të ofrojmë rekomandime për ndryshime konkrete. Nga rezultatet e nxjerra do të shohim se gjendja e arsimit në vendrrjedhë si pasojë e mosarritjes së përmirësimit të metodave në mësimdhënie dhe vlerësimit në përputhje me kornizën kurrikulare, si dhe faktorëve të tjerë. Prandaj, për ta përmirësuar këtë gjendje, kërkohet një reformim i thellë në arsimin parauniversitar. Mostra do të jenë rezultatet e testeve të arritshmërisë dhe atij të maturës, nga dokumentet

Abstract

Assessment is the process of collecting data and judging the value of achieving learning outcomes, based on levels of achievement. The Curricular Framework of Pre-University Education in Kosovo defines two types of assessment: internal assessment and external state assessment. Since 2015, Kosovo has been subject to the PISA international assessment. The purpose of the study is to analyse the rise and fall of education in Kosovo, based on the results of national tests and PISA. By comparing and evaluating the results of the national tests and the PISA test, as well as through the analytical method, we will highlight the current situation of the education system in Kosovo, namely we will identify the factors and causes that influence the rise or fall of the quality of education in place, as well as we will offer recommendations for concrete changes. From the results, we will see that the state of education in the country is a consequence of the failure to improve teaching and assessment methods in accordance with the curriculum framework, as well as other factors. Therefore, to improve this situation, a deep reformation in pre-university education is required. The samples will be the results of the achievement and matriculation tests, from the relevant documents, in four school years:

³¹ Msc. Sevdije Berisha Krasniqi është mësimdhënëse berishasevda349@gmail.com
Msc. Sevdije Berisha Krasniqi is a teacher berishasevda349@gmail.com

përkatëse, në katër vite shkollore: 2014-2015, 2017-2018, 2021-2022 dhe 2023-2024, si dhe rezultatet e testit PISA të viteve 2015, 2018 dhe 2022.

Fjalët kyçe: vlerësim, ngritje, rënie, kombëtar, ndërkombëtar.

2014-2015, 2017-2018, 2021-2022 and 2023-2024, as well as the results of the PISA test of 2015, 2018 and 2022.

Keywords: evaluation, rise, fall, national, international.

KRAHASIMI I VLERËSIMEVE KOMBËTARE ME PËRVOJA NGA VENDET E TJERA

COMPARISON OF NATIONAL ASSESSMENTS WITH THE EXPERIENCES OF OTHER COUNTRIES

Egzon Gashi³²

Abstrakt

Ky studim synon të analizojë vlerësimin e performancës së mësimit në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës duke përdorur teorinë socio-kulturore si strukturë konceptuale. Për të arritur objektivat e studimit, një metodologji e metodave të përziera është përdorur për të kuptuar qëndrimet e mësuesve ndaj vlerësimit, përfshirjen e drejtorëve në proces, si dhe vlerësimin e nxënësve për mësimit. Studimi është bazuar në një përpjekje për të kuptuar më mirë kontekstin e vlerësimit të performancës së mësimit në një mjedis shoqëror dhe kulturor specifik, siç është Kosova. Duke u përqendruar në teorinë socio-kulturore, studimi synon të identifikojë ndikimin e faktorëve socio-kulturorë në perceptimin dhe praktikën e vlerësimit të performancës së mësimit. Rezultatet e studimit tregojnë një gamë të gjerë të qëndrimeve dhe perceptimeve të mësimit në lidhje me vlerësimin e performancës së tyre, si dhe nivelet e përfshirjes së drejtorëve në këtë proces. Në të njëjtën kohë, vlerësimi i nxënësve për mësimit është shqyrtuar për të kuptuar ndikimin e vlerësimit të tyre në përmirësimin e performancës së mësimit. Hulumtimi synon të ofrojë një kontribut të rëndësishëm për praktikën e arsimit

Abstract

This study aims to analyze the evaluation of teachers' performance in the educational system of the Republic of Kosovo using the socio-cultural theory as a conceptual structure. To achieve the objectives of the study, a mixed methods methodology was used to understand teachers' attitudes towards evaluation, principals' involvement in the process, as well as students' evaluation of teachers. The study is based on an attempt to better understand the context of teacher performance evaluation in a specific social and cultural environment, such as Kosovo. Focusing on socio-cultural theory, the study aims to identify the influence of socio-cultural factors on the perception and practice of teachers' performance evaluation. The results of the study show a wide range of teachers' attitudes and perceptions regarding the evaluation of their performance, as well as the levels of principals' involvement in the process. At the same time, students' evaluation of teachers has been examined to understand the impact of their evaluation on improving teachers' performance. The research aims to provide an important contribution to education practice in Kosovo, helping to develop a deeper

³² MA Egzon Gashi, OJQ Teach For Kosova Egzon.gashi@teachforkosova.org
MA Egzon Gashi, NGO Teach For Kosova Egzon.gashi@teachforkosova.org

në Kosovë, duke ndihmuar në zhvillimin e një kuptimi më të thellë të proceseve të vlerësimit të performancës së mësimit dhe duke identifikuar fushat potenciale për përmirësim.

Fjalët kyçe: vlerësimi i performancës së mësimit, teoria socio-kulturale, vlerësimi i nxënësve, drejtorët e shkollave.

understanding of teacher performance evaluation processes and identifying potential areas for improvement.

Keywords: teacher performance evaluation, socio-cultural theory, student evaluation, school principals.

**TEMA 4. QASJET DHE STRATEGJITË E PËRDORIMIT EFEKTIV TË
REZULTATEVE TË VLERËSIMEVE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE**

**TOPIC 4. APPROACHES AND STRATEGIES FOR THE EFFECTIVE USE OF
NATIONAL AND INTERNATIONAL ASSESSMENT RESULTS**

VLERËSIMI I NXËNËSVE I REFLEKTUAR NË LIBRAT SHKOLLORË NË KOSOVË DHE EFEKTI E TIJ NË PRAKTIKËN E MËSIMDHËNIES

STUDENT'S ASSESSMENT REFLECTED IN THE KOSOVO TEXTBOOKS AND ITS INTERPLAY IN THE TEACHING PRACTICE

Mihaela Singer³³, Armend Shabani³⁴, Dije Shatri, Fadil Latifi³⁵, Osman Buleshkaj³⁶

Abstrakt

Vlerësimi efektiv është kyç, si për ta kuptuar nivelin e nxënësit në arritjen e rezultateve të të nxënësit ashtu edhe për përparimin e tij/saj në të nxënë. Një analizë gjithëpërfshirëse e teksteve të gjuhës shqipe dhe të matematikës, të përdorura në arsimin e detyrueshëm në Kosovë, tregon se shumë tekste nuk arrijnë të përfshijnë një shumëllojshmëri të vlerësimeve formuese dhe përmbledhëse. Ndërsa një numër i kufizuar tekstesh shkollorë përfshijnë strategji vlerësimi që fokusohen në kompetencat e rekomanduara, inkurajojnë përparimin dhe nxisin të nxënëit me të kuptuar, shumica e teksteve mbështeten vetëm në memorizimin e fakteve dhe procedurave. Rezultatet e PISA-s përcjellin atë që analiza e teksteve shkollorë zbulon në mënyrë konvergjente: nga njëra anë nxënësit kanë vështirësi të mëdha në zgjidhjen e detyrave në shikim të parë dhe aplikimeve të jetës reale, nga ana tjetër, shumica e teksteve shkollorë e injorojnë ekspozimin e nxënësve ndaj atyre llojeve të aktiviteteve.

Abstract

Effective assessment is key for both understanding a student's level in attaining the learning outcomes and his/her progress in learning. A comprehensive analysis of the textbooks for Albanian language and Mathematics used in compulsory education in Kosovo shows that many textbooks fail to include a variety of formative and summative assessments. While a limited number of textbooks incorporate assessment strategies that focus on the recommended competencies, encourage progress, and stimulate learning with understanding, most textbooks rely only on the memorization of facts and procedures. PISA results convey what the textbook analysis reveals convergently: on the one hand, students have major difficulties in solving first-sight tasks and real-life applications, on the other hand, most textbooks ignore students' exposure to those types of activities. As teachers heavily rely on textbooks in their classroom activities, the

³³ Dr. Mihaela Singer, eksperte nga projekti EU-KosED

Dr. Mihaela Singer, expert from EU-KosED project

³⁴ Dr. Armend Shabani, profesor në Fakultetin e Shkencave Matematike

Dr. Armend Shabani, professor at the Faculty of Mathematical Sciences

³⁵ Dr. Fadil Latifi, mësimdhënës dhe hulumtues

Dr. Fadil Latifi, teacher and researcher

³⁶ Dr. Osman Buleshkaj, bashkëpunëtor shkencor në IPK

Dr. Osman Buleshkaj, associate researcher at KPI

Meqenëse mësuesit mbështeten shumë te tekstet shkollore në aktivitetet e tyre në klasë, praktika e mësimdhënies rrit fokusin në detyrat e përsëritura, algoritmike dhe të dekontekstualizuara. Punimi analizon më në detaje këto korrelacione dhe sugjeron disa strategji për ta kapërcyer këtë cikël dështimi.

Fjalët kyçe: vlerësimi formues dhe përmbledhës, analiza e librave shkollorë, kompetencat, rezultatet e PISA-s.

teaching practice amplifies the focus on repetitive, algorithmic, decontextualized tasks. The paper analyses in more detail these correlations and suggests some strategies to overcome this cycle of failure.

Keywords: formative and summative assessment, Textbook Analysis, Competencies, Pisa results.

QASJA METODIKE E MËSIMDHËNËSVE NË ZHVILLIMIN E LEXIM-KUPTIMIT TE NXËNËSIT

TEACHERS' METHODOICAL APPROACH TO THE DEVELOPMENT OF STUDENTS' READING COMPREHENSION

Bekim Morina³⁷, Zehrije Plakolli³⁸, Arbnesha Mexhuani³⁹ & Agim Bujari⁴⁰

Abstrakt

Qasja metodike e mësimdhënësve në zhvillimin e lexim-kuptimit është faktor me rëndësi në formimin e aftësive bazë të nxënësve dhe ndikon drejtpërdrejt në rezultatet e tyre në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky studim eksploron praktikat metodike që mësimdhënësit i përdorin për të përmirësuar lexim-kuptimin te nxënësit, duke analizuar efektivitetin e strategjive të ndryshme të mësimdhënies. Qëllimi i hulumtimit është identifikimi i qasjes metodike të mësimdhënësve gjatë procesit mësimor në zhvillimin e aftësive të nxënësve për të kuptuar përmbajtjen e tekstit. Në fokus të studimit ishin përdorimi i teknikave të leximit aktiv në klasë, parashtrimi i pyetjeve kritike, përdorimi i teksteve të shumëllojshme, zhvillimi i diskutimeve interaktive, si dhe stimulimi i mendimit kritik. Studimi ndjek një qasje të përzier (sasiore dhe cilësore). Mostra ka qenë e qëllimshme dhe përbëhet nga 20 mësimdhënës (10 mësimdhënës të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, që japin mësim në klasat e shtata, dhe 10 mësimdhënës të klasave të

Abstract

Teachers' methodical approach to the development of reading comprehension plays a key role in the development of students' basic skills and directly affects their results in national and international assessments. This study explores the methodological practices that teachers use to improve students' reading comprehension, analyzing the effectiveness of different teaching strategies. The purpose of the research is to identify the methodical approach of teachers during the teaching process in the development of students' abilities to understand the content of the text. The focus of the study was the use of active reading techniques in the classroom, posing critical questions, using diverse texts, developing interactive discussions, as well as stimulating critical thinking. The study follows a mixed approach (quantitative and qualitative). The sample was purposive and consists of 20 teachers (10 Albanian Language and Literature teachers, who teach seventh grades, and 10 fifth grade

³⁷ Bekim Morina, PhDc, hulumtues në IPK bekimmorina1979@gmail.com

Bekim Morina, PhDc, researcher at KPI bekimmorina1979@gmail.com

³⁸ MA Zehrije Plakolli, hulumtuese në IPK Zehrie.Plakolli@rks-gov.net

MA Zehrije Plakolli, researcher at KPI Zehrie.Plakolli@rks-gov.net

³⁹ MA Arbnesha Mexhuani, hulumtuese në IPK Arbnesha.Mexhuani@rks-gov.net

MA Arbnesha Mexhuani, researcher at KPI Arbnesha.Mexhuani@rks-gov.net

⁴⁰ Agim Bujari, PhDc, hulumtues në IPK agim.bujari@rks-gov.net

Agim Bujari, PhDc, researcher at KPI agim.bujari@rks-gov.net

pesta) dhe 400 nxënës të klasës së pestë dhe të shtatë. Të dhënat janë siguruar nëpërmjet intervistës gjysmë të strukturuar dhe protokollit të vëzhgimit me mësimdhënës, si dhe pyetësorit me nxënës. Rezultatet e studimit tregojnë se mësimdhënësit kanë vështirësi në gjetjen e strategjive efektive për të zhvilluar aftësitë e kuptimit të tekstit të nxënësit. Vëzhgimet në orët mësimore dëshmojnë se mësimdhënësit rrallë përdorin strategji që zhvillojnë aftësitë e nxënësve për të kuptuar përmbajtjen e tekstit. Rezultatet e dalta nga hulumtimi tregojnë se mësimdhënësit kanë njohuri të kufizuara për strategjitë e lexim-kuptimit dhe zbatimin e tyre në praktikë, prandaj nxënësit kanë vështirësi të kuptojnë tekstin që e lexojnë dhe të interpretojnë përmbajtjen e tij, vështirësi këto që ndikojnë në rezultatet e ulëta në testet kombëtare dhe ndërkombëtare. Studimi nxjerr në pah rëndësinë e qasjeve metodike të mësimdhënies për zhvillimin e lexim-kuptimit të nxënësit dhe se strategjitë e ndryshme mësimore janë thelbësore për përmirësimin e rezultateve të nxënësve në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Rekomandohet që në të ardhmen mësimdhënësit të trajnohen për përdorimin e strategjive mësimore që përmirësojnë zhvillimin e aftësive të nxënësve për lexim-kuptimin.

Fjalët kyçe: mësimdhënës, nxënës, kuptimi i leximit, strategji të mësimdhënies, vlerësim.

teachers) and 400 fifth and seventh grade students. The data were obtained through a semi-structured interview and observation protocol with teachers, as well as questionnaires with students. The results of the study show that teachers encounter difficulties in finding effective strategies to develop students' reading comprehension skills. Classroom observations showed that teachers rarely use strategies that develop students' abilities to understand text content, while the results from teacher interviews and student surveys show that teachers have limited knowledge of reading comprehension strategies and ways of their implementation in practice, therefore students have difficulties to understand the text they read - the interpretation of its content, these difficulties affect the low results in national and international tests. The study highlights the importance of methodical teaching approaches for the development of reading comprehension and that different teaching strategies are essential for improving students' results in text comprehension and in national and international assessments. It is recommended that in the future teachers are trained to use teaching strategies that improve the development of students' reading comprehension skills.

Keywords: teacher, students, reading comprehension, teaching strategies, assessment

EKSPLORIMI I MARRËDHËNIEVE NË MES TË ANGAZHIMIT, KËNAQËSISË, KOMPETENCËS SË PERCEPTUAR, VËSHIRËSISË SË PERCEPTUAR NË LEXIM DHE ARRITJEVE NË LEXIM

EXPLORING THE RELATIONSHIPS BETWEEN READING ENGAGEMENT, ENJOYMENT, PERCEIVED COMPETENCE, PERCEIVED DIFFICULTY, AND READING ACHIEVEMENT

Gjylë Totaj⁴¹, Fatmir Mehmeti⁴² & Artan Reshani⁴³

Abstrakt

Qëllimi këtij studimi është t'i eksplorojë marrëdhëniet dhe ndikimin në mes të angazhimit në lexim, kënaqësisë nga leximi, kompetencës së perceptuar të leximit, vështirësisë së perceptuar në lexim dhe arritjeve në lexim në testin PISA. Të dhënat janë mbledhur nga vlerësimi PISA 2018, në të cilin morën pjesë gjithsej 5058 nxënës (2457 femra dhe 2601 meshkuj), në 224 shkolla, që përfaqësojnë 25739 nxënës 15-vjeçar në Kosovë. Variabla e varur në këtë punim përfshin rezultatin e arritur nga nxënësit kosovarë në lexim. Variablat e pavarura përfshijnë pyetjet mbi angazhimin e nxënësve në lexim, kënaqësisë nga leximi, perceptimeve të kompetencës së të lexuarit dhe vështirësisë së perceptuar në lexim. Për analizën e të dhënave është përdorur programi The International Association for the Evaluation of Educational Achievement (IEA) International Database (IDB) Analyser. Analiza e korrelacionit, e regresionit, është realizuar për të shqyrtuar korrelacionet dhe ndërveprimet midis angazhimit në lexim, kënaqësisë nga leximi, perceptimit të

Abstract

The purpose of this study is to explore the relationship and influence between reading engagement, reading satisfaction, perceived reading competence, perceived reading difficulty and reading achievement in the PISA test. The data was collected from the PISA 2018 assessment, in which a total of 5,058 students (2,457 females and 2,601 males) participated in 224 schools, representing 25,739 15-year-old students in Kosovo. The dependent variable in this paper includes the result achieved by Kosovar students in reading. Independent variables include questions on students' reading engagement, reading enjoyment, perceptions of reading competence, and perceived reading difficulty. The International Association for the Evaluation of Educational Achievement (IEA) International Database (IDB) Analyser programme was used for the data analysis. Correlational regression analysis was conducted to examine correlations and interactions between reading engagement,

⁴¹ Prof. ass. dr. Gjylë Totaj, Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, Fakulteti i Edukimit gjyle.totaj@uni-prizren.com
Prof. Ass. Dr. Gjylë Totaj, "Ukshin Hoti" University in Prizren, Faculty of Education gjyle.totaj@uni-prizren.com

⁴² Prof. asoc. dr. Fatmir Mehmeti, Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, Fakulteti i Edukimit fatmir.mehmeti@uni-prizren.com
Prof. Ass. Dr. Fatmir Mehmeti, "Ukshin Hoti" University in Prizren, Faculty of Education fatmir.mehmeti@uni-prizren.com

⁴³ Prof. ass. dr. Artan Reshani, Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, Fakulteti i Edukimit artan.reshani@uni-prizren.com
Prof. Ass. Dr. Artan Reshani, "Ukshin Hoti" University in Prizren, Faculty of Education artan.reshani@uni-prizren.com

kompetencës së të lexuarit, vështirësisë së perceptuar në lexim dhe arritjeve të testit PISA. Rezultatet tregojnë se kënaqësia nga leximi dhe perceptimi i kompetencës së të lexuarit kanë ndikime të rëndësishme pozitive me performancën në lexim. Gjetjet tregojnë se mësuesit luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e kulturës së të lexuarit dhe përmirësimin e arritjeve në të lexuar te nxënësit në Kosovë. Promovimi i një mjedisi pozitiv leximi, rritja e besimit të nxënësve në aftësitë e tyre të leximit dhe adresimi i vështirësive të perceptuara në të lexuar, janë strategji thelbësore për përmirësimin e arritjeve të nxënësve në lexim dhe nxitjen e zhvillimit të leximit.

Fjalët kyçe: angazhimi, kënaqësia, vështirësia, kompetenca, leximi, PISA.

reading enjoyment, perceived reading competence, perceived reading difficulty, and PISA test achievement. The results show that enjoyment of reading and perception of reading competence have significant positive impacts on reading performance. The findings show that teachers play an important role in fostering a culture of reading and improving reading achievement among students in Kosovo. Promoting a positive reading environment, increasing students' confidence in their reading abilities, and addressing perceived reading difficulties are essential strategies for improving student reading achievement and fostering reading development.

Keywords: engagement, enjoyment, difficulty, competence, reading, PISA.

BASHKËPUNIMI I MËSIMDHËNËSVE LIDHUR ME VLERËSIMIN GJATË PROCESIT MËSIMOR

TEACHER COOPERATION RELATED TO ASSESSMENT DURING THE LEARNING PROCESS

Isak Kelmendi⁴⁴

Abstrakt

Kjo veprimtari filloi duke pasur parasysh se barra kryesore, për të ngritur cilësinë në arsim, në radhë të parë, duhet të bjerë mbi mësimitdhënësit, por të vetëdijshëm për nevojën e mbështetjes institucionale dhe të shoqërisë në tërësi. Ndërmarrja do të jetë hulumtim në veprim, mësimitdhënësit do të vëzhgojnë në orën e njëri-tjetrit. Vlerësimi do të bëhet për veprimtaritë konkrete në orë, si:

rezultatet e të nxënimit të orës, kriteret e të nxënimit, burimet, mjetet e konkretizimit, lidhja me lëndët e tjera mësimore, a është përmbajtja e lidhur me kriteret, vlerësimi i nxënësve, puna e pavarur, motivimi i nxënësve. Të gjitha do të vlerësohen me notë numerike: 1,2,3,4,5, duke u shprehur edhe me fjalë. Një shembull i mirë i orës dhe paraqitja e ndonjë risie do të shënohen me fjalë. Pas çdo ore të vëzhguar, do të diskutohet për të gjitha këto dhe do të jenë si pikë orientuese për mësimitdhënësin që do të mbajë orën tjetër. Të gjithë ne, kur e bëjmë një punë, kemi dëshirë që të na vlerësojë dikush, të japë një mendim. Ky është qëllimi i kësaj ndërmarrjeje, që secili të ketë mundësi të vlerësohet dhe të vlerësojë. Duke vëzhguar në orët e njëri-tjetrit, do të kenë mundësi të shohin metoda të ndryshme të punës dhe t'i praktikojnë në orët e tyre. Pra, mësimitdhënësit do të plotësojnë njëri-

Abstract

This activity started with the consideration that the main burden to raise the quality in education, should fall on the teachers in the first place, but aware of the need for the support of institutions and society as a whole. The enterprise will be research in action, the teachers will observe on each other's lessons. The evaluation will be done for the concrete lesson activities, such as: Learning outcomes of the lesson, learning criteria, resources, concretization tools, connection with other teaching subjects, is the content related to the criteria, student assessment, independent work, student motivation. All will be evaluated with a numerical grade: 1, 2, 3, 4, 5 which will also be expressed in words. A good example of the lesson and the presentation of any novelty will be marked with words. After each observed lesson, all these will be discussed and will serve as a reference point for the teacher who will hold the next lesson. All of us like to get some evaluation or feedback when we do a job. This is the purpose of this enterprise, so that everyone has the opportunity to evaluate and to be evaluated.

By observing each other's lessons, they will have the opportunity to see different work methods and practice them in their classes. Thus, the teachers will complement each other. Let us try to create a

⁴⁴ Isak Kelmendi, mësimitdhënësi në SHFMU "Ibrahim Fehmiu" në Prizren Isak.kelmendi@hotmail.com
Isak Kelmendi, teacher at Ibrahim Fehmiu school in Prizren Isak.kelmendi@hotmail.com

tjetrin. Të përpiqemi të krijojmë një kulturë bashkëpunimi në shkollë dhe mësimdhënësit të ndihen të sigurt e të kënaqur me punën e tyre. Kjo do të reflektojë pa dyshim edhe te nxënësit dhe për ngritjen e cilësisë në arsim. Bartës të punës do të jenë mësimdhënësit, të paraqitur vullnetarë (8 mësimdhënës/e). Çdo mësimdhënës vëzhgues do të ketë fletët e përgatitura, për vlerësim të veprimtarive në orë. Të dhënat mbledhen dhe nxirret nota mesatare (metoda sasimore). Analizohen komentet me shkrim të vëzhguesve dhe vazhdimisht mbahen shënime për përshtypjet e reagimet e mësimdhënësve (metoda cilësore). Në fletët ku do t'i shënojnë të dhënat mësimdhënësit nuk do të shënojnë emrat e tyre, në mënyrë që çdo gjë të jetë konfidenciale. Nga e gjithë kjo rezultoi se vlerësimi për veprimtaritë brenda orës ishte pozitiv, me gjithë shqetësimin e mësimdhënësve se do të jetë subjektiv. Gjatë vëzhgimit janë përshkruar të gjitha elementet e mira të orës, por edhe disa mangësi. Kjo ishte bazë e mirë për t'i diskutuar dhe për t'i vërë në pah për të gjithë, si mundësi për të marrë e për të dhënë përvoja. Të gjithë shpreheshin se po mësojnë nga njëri-tjetri. Në fund mësojmë se kjo frymë e bashkëpunimit mund dhe duhet të ndërtohet, së pari nga mësimdhënësit dhe me ndihmën e institucioneve, të cilat duhet të gjejnë mundësitë dhe format që të mbështesin mësimdhënësit.

Fjalët kyçe: mësimdhënësit, cilësia, bashkëpunimi, vëzhgimi, diskutimi, rezultatet.

culture of cooperation in schools, for teachers to feel safe and satisfied with their work. This will undoubtedly reflect on the students and on the improvement of the quality in education. The persons responsible for the work will be the teachers, presented as volunteers (8 teachers). Each observing teacher will have sheets prepared to evaluate the activities in class. The data is collected and the average grade is derived (quantitative method). The written comments of the observers are analyzed and notes are constantly kept about the impressions and reactions of the teachers (qualitative method). The teachers will not write their names on the sheets where they will record the data, so that everything will be confidential. The result of this activity was that the evaluation of the activities within the lesson was positive, despite the teachers' concern that it will be subjective. During the observation, all the good elements of the lessons were described, but also some shortcomings. This was a good basis to discuss and highlight them for everyone, as an opportunity to receive and share experiences. Everyone expressed that they are learning from each other. In the end, we learn that this spirit of cooperation can and should be built, first by the teachers and with the help of the institutions, which should find the opportunities and forms to support the teachers.

Keywords: teachers, quality, cooperation, observation, discussion, results.

KALIMI NGA VLERËSIMI TRADICIONAL “LAPS-LETËR” DREJT VLERËSIMIT ELEKTRONIK TË NXËNËSVE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

THE TRANSITION FROM THE TRADITIONAL "PEN AND PAPER" ASSESSMENT TO THE ELECTRONIC ASSESSMENT OF STUDENTS IN PRE- UNIVERSITY EDUCATION

Lulzim Thaçi⁴⁵ & Agim Bujari⁴⁶

Abstrakt

Në kohën e sotme të digjitalizimit, metodat tradicionale të vlerësimit po zëvendësohen gradualisht me sisteme të vlerësimit elektronik, të cilat ofrojnë fleksibilitet, duke lehtësuar krijimin, administrimin dhe analizën e vlerësimit. Në shumë hulumtime, si p.sh. Hanifi, Aissa (2019), konstatohet se rëndësia e vlerësimit elektronik qëndron në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të vlerësimit, sepse eliminon subjektivitetin nga mësuesit, duke qenë i barasvlershëm. Qëllimi i këtij punimi është që, përmes një analize të literaturës, të argumentohet se përdorimi i teknologjisë për vlerësimin e nxënësve sjell ndryshime në qasjen se si shkollat mund të vlerësojnë arritjet e nxënësve. Po ashtu, do të bëhet analiza e ndryshimeve që ndodhin në procesin e vlerësimit kur kalohet nga testet tradicionale me “laps-letër” drejt metodave elektronike, identifikimi i avantazheve dhe sfidave që sjell vlerësimi elektronik në krahasim me metodat tradicionale, identifikimi i praktikave më të mira për integrimin e vlerësimit elektronik në arsimin parauniversitar. Hulumtimet për vlerësimin

Abstract

In today's age of digitalization, traditional assessment methods are gradually being replaced by electronic assessment systems, providing flexibility, facilitating assessment creation, administration and analysis. Many studies, such as Hanifi, Aissa (2019), have concluded that the importance of electronic assessment lies in increasing the quality and efficiency of assessment, because it eliminates subjectivity from teachers, being equivalent. The purpose of this paper is to argue, through an analysis of the literature, that the use of technology for student assessment brings changes in the approach to how schools can assess student achievement. Further, the analysis of the changes that occur in the assessment process when moving from traditional "pen and paper" tests to electronic methods, the identification of the advantages and challenges that electronic assessment brings compared to traditional methods, the identification of best practices for the integration of electronic assessment in pre-university education. Research on assessment in Kosovo is scarce (Thaçi, 2020).

⁴⁵ Dr. Lulzim Thaçi, ligjërues i lëndëve të Fizikës në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, Kolegji UBT lulzimthaqi@gmail.com
Dr. Lulzim Thaçi, lecturer of Physics subjects in the Faculty of Medical Sciences, UBT College lulzimthaqi@gmail.com

⁴⁶ Agim Bujari, PhDc, hulumtues për mësimdhënie dhe zhvillim profesional të mësimdhënësve në IPK agim.bujari@rks-gov.net
Agim Bujari, PhDc, researcher of teaching and professional teacher development at KPI agim.bujari@rks-gov.net

në Kosovë janë të pakta, Thaçi, L. (2020). Ai identifikon përdorimin e aplikacionit Matu, i cili më 2017 ishte lansuar si pilotim për përgatitjen e maurantëve për testin e maturës dhe platforma Evaluo, si e vetmja platformë për vlerësim elektronik në gjuhën shqipe. Interesimi i nxënësve dhe mësimitdhënësve për përdorimin e vlerësimit elektronik ishte me shifra mjaft të larta. Këto raste studimore dhe shembuj praktikë ofrojnë një perspektivë të gjerë mbi mënyrën si shkollat, por edhe institucionet arsimore, mund të ndryshojnë dhe të përshtaten me këtë paradigëmë të re të vlerësimit shkollor.

Fjalët kyçe: Matu, Evaluo, paradigma e vlerësimit, vlerësimi “laps-letër”, vlerësimi elektronik.

He identifies the use of the Matu application, which was launched in 2017 as a pilot for the preparation of graduates for the matura test, and the Evaluate platform, as the only platform for electronic assessment in the Albanian language. The interest of students and teachers in the use of electronic assessment was quite high. These case studies and practical examples provide a broad perspective on how schools, but also educational institutions, can change and adapt to this new paradigm of school assessment.

Keywords: “Matu” platform, “Evaluate” platform, assessment paradigm, “pen and paper” assesment, electronic assessment.

Botues/Publisher

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Kosovo Pedagogical Institute

<https://ipkmasht.rks-gov.net>